



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Drejtues Finance”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Qiriazi”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Gentiana SHARKU

Dr. Andromahi KUFO

Shtator / 2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Qiriazi" ka filluar aktivitetin si institucion privat i arsimit të lartë në vitin akademik 2006 - 2007, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.274, datë 10.05.2006, "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Private "Sevasti & Parashqevi Qiriazi" (*Anex_I_19_Akte nenligjore KUQ*). Fillimisht u krijua Fakulteti i Ekonomisë, i cili ofronte, tre programe studimi, "Financë", "Drejtues Finance", "Drejtues Kontabiliteti" me kohëzgjatje 4 vjet. Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 258 datë 27.02.2008 u hap programi Banka dhe Institucionet Financiare, Administrim Publik, Marketing, Turizëm. Në vitet 2014-2015, 2015-2016, veprimtaria e institucionit ka qenë e pezulluar. Me urdhër të MASR Nr.397 dt. 22.07.2016 Kolegjit iu hoq pezullimi i veprimtarisë.

Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 92, dt. 01.03.2017 institucioni riorganizohet nga Shkollë e Lartë Universitare Private "Sevasti & Parashqevi Qiriazi" në Kolegjin Universitar "Qiriazi", dhe miratohet Statuti i ri (*Anex_I_19_Akte nenligjore KUQ*).

Sipas Statutit të ri dhe Rregullores së re aktualisht Kolegji Universitar "Qiriazi" është i organizuar në tre njësi kryesore:

1. Fakulteti i Ekonomisë;
2. Fakulteti i Drejtësisë;
3. Kolegji Profesional i Lartë;

Ky program studimi është licensuar me anë të VKM Nr. 274, datë 10.05.2006. si Bachelor në "Drejtues Finance", (4 vite akademike). Me anë të Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 369, datë 12.11.2009 "Për Akreditimin me Kusht të Institucionit dhe të Programeve të Studimit të Shkollës së lartë Universitare Private "SEVASTI & PARASHQEVI QIRIAZI", akreditohet me kusht ky program studimi. Me anë të Vendimit të Këshillit të Akreditimit Nr. 89, datë 03.9.2010, hiqen kushtet e akreditimit për këtë program studimi. Raporti i Vlerësimit nga Ekspertët e Jashtëm, shqyrton ecurinë e programit ndër vite. Ky raport përshkruan analizën mbi treguesit e matshëm, si dhe shkallën e përbushjes së standarteve Programi është në funksion të përbushjes së misionit dhe objektivave të Kolegjit.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017” ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyruar dokumentacionin e përcjellë nga KUQ për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Gentiana Sharku, pedagoge ne FEUT, Departamenti i Financës, Dr. Andromahi Kufo, pedagoge ne Universitetin New York Tirana, Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë, Departamenti i Financës. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demireli.

Pas komunikimit dhe trajnimit nga ASCAL mbi kriteret e reja të vlerësimit në ndërtesën e tyre, ekspertëve të jashtëm ju vendos ne dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktuan edhe datat e vizitave në institucion. Datat e vizitave 1 dhe 2 korrik u përmbushën me sukses në kampusin e KUQ. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës. I gjithë stafi akademik dhe administrativ i KUQ u angazhua për t’iu përgjigjur kërkesave të grupit të jashtëm. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 11 korrik 2019.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve dhe specialistes së ASCAL, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për cdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Bachelor në “Drejtues Finance”. Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë SWOT mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Kolegji Universitar “Qiriazi” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 16.09.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 143/36 Prot, datë 16.09.2019. Ku Qiriazi përcjell në ASCAL më datë 24.09.2019, me anë të shkresës me Nr. 207 Prot, datë 20.09.2019 “Dërgim mendimesh”, komente mbi Draft Raportin. Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Në lidhje me standartin I.5, kriteri 3 nuk jemi dakord me komentin tuaj. Kur flasim për "raportin analitik të përfitimeve" i referohemi një analize periodike të bashkëpunimeve ku duhet të referohet rezultati i arritur nga këto marrëveshje, sa të efektshme kanë qenë këto marrëveshje, çfarë përfitime ekonomike kanë pasur të cilat do të shërbenin për situatën financiare të Kolegjit, ose përfitimeve personale nga ana e pedagogëve për ndonjë cmim apo njohje ndërkombëtare. Nga institucioni është vënë në dispozicion vetëm lista analitike e bashkëpunimeve. **Nuk ka ndryshime në Raport** lidhur me këtë koment.
2. Në lidhje me komentin tek standarti VI.1, kriteri 2 dhe 4, ju sqarojme se vlerësimi nuk i referohet cilësisë së stafit (individëve) që përfshihet në process apo punës që ata kanë kryer, por funksionimit real të procesit në sigurimin e cilësisë. Nëse në të gjitha hallkat është i njëjti personel nuk sigurohet "4 eyes principle" sic edhe duhet në cdo proces.

Cilësia e stafit të kolegjit nuk vihet në diskutim, madje është përmendur edhe si pikë e fortë e institucionit. **Nuk ka ndryshime në Raport** lidhur me këtë koment.

3. Në lidhje me komentin tek standarti VI.4, kriteri 2, **ndryshojmë në raport** si më poshtë:
“Sipas rregullores së Kolegjit, Zyra NJSBC përbëhet nga drejtuesit e zyrës, tre anëtarë të personelit akademik dhe një përfaqësues të studentëve, por në takimin që GVJ pati, nuk kishte student të pranishëm. Po ashtu në raportet e Njesisë nuk vërehet pjesëmarrja e studentit si pjesë e Njesisë.”
4. Në lidhje me komentin tek standarti VI.4, kriteri 5, **ndryshojmë në raport** si më poshtë:
“Sipas RVB-se, KUQ ka angazhuar edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.GVJ gjatë vizitës së tij nuk është njohur me ekspert të jashtëm pjesë të NJSBC.”
5. Së fundmi në lidhje me vlerësimin tërësor, ju sqarojmë se vlerësimi final lidhet me vlerësimin e cdo standarti dhe jo me mbledhjen aritmetike të standarteve.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Drejtues Finance”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit të ciklit të parë “Drejtues Finance” i ofruar nga Departamenti i Financës, përmban lëndë dhe kurrikula, përmbajtja e të cilave nuk bie ndesh me interesat kombëtare.
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Sikurse përcaktohet në nenin nr. 3 të Statutit të KU “Qiriazi”, programet e studimit të ofruara nga ky institucion mbështeten në traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit duke synuar ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë Bsc në “Drejtues Finance” është mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në udhëzimet

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>e MAS, si edhe në Statutin dhe Rregulloren e KU “Qiriazi” dhe në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë. Në këtë mënyrë program i studimit i rregulluar nga kjo rregullore ofrohet në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë së tij të përcaktuara në statutin e tij.</p> <p><i>Nga dokumentat e vëna në dispozicion ky program quhet “Drejtues Finance”, ndërkohë rregullorja programit dhe dokumente të tjera të vëna në dispozicion i referohen programit me emërtimin “Financë”. Ka një mospërputhje midis tyre.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë “Drejtues Finance” është hartuar dhe ofruar në mënyrë që të nxisë zhvillimin ekonomik lokal dhe /ose kombëtar. Neni nr. 3 i Statutit të KU “Qiriazi” pika (c) shpreh misionin e tij për të kontribuar në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Senati Akademik i KU “Qiriazi” ka miratuar “Planin Strategjik të Zhvillimit të KU “Qiriazi” 2016-2021”, ku përcaktohen objektivat e Institucionit dhe njërive përbërëse të tij si edhe mjetet dhe veprimet e realizimit të këtyre objektivave. Të gjitha programet e studimit të ofruara nga ky institucion janë ofruar në mbështetje të këtij plani strategjik të institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti dhe rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Drejtues Finance” përcaktojnë drejtimit prioritar akademike si: përgatitjen e specialistëve të lartë me dije të nivelit bashkëkohor; kryerjen e studimeve kërkimore dhe shkencore në fushat që mbulon, si dhe bashkëpunimin me institucione homologe dhe aktorë të biznesit si brenda edhe jashtë vendit.</p> <p><i>(Anex_I_1_Statuti_i_KUQ),</i></p> <p><i>(Anex_III_1_Rregullore_e_Program_Studimi).</i></p>

Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Drejtues Finance” ofrohet nga Departamenti i Financës, i Fakultetit Ekonomik të KU “Qiriazi”. Në këtë mënyrë struktura dhe përmbajtja e këtij programi studimi është në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë të kolegjit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	<p>Neni nr. 4 i Rregullores së programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Drejtues Finance” përcakton qartë objektivat kryesorë të programit, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgatitjen e studentëve që të jenë të aftë në karrierën e tyre në fushën e kontabilitetit dhe të manaxhimit financiar, si në sektorin privat edhe në atë publik; • Formimin e specialistëve të fushës së manaxhimit dhe analizës financiare dhe kontabël me nivel të lartë në aftësi profesionale dhe përgjegjësi sociale. • Kombinimin e dijeve teorike që marrin studentët me elementë të praktikës në mënyrë që të përshtaten dhe të orientohen me nevojat konkrete të tregut të punës; • Mundësimin e vazhdimit të studimeve në ciklin e dytë të studimeve në “Master Profesional” dhe në “Master i Shkencave”.
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të	<p>Institucioni ka pëfshirë në DVV që i është vënë në dispozicion GVJ-së, një dokument nëpërmjet të cilit ka analizuar nevojat e tregut për zhvillimin e programeve në bachelor dhe master të KU “Qiriazi”. (Ref <i>Anex-I-12</i>)</p> <p>Pavarësisht nga çfarë është prezantuar në RVB, GVJ konstatoi se analiza është shumë e përciptë dhe jo e plotë. Madje edhe ato pak shifra që janë dhënë i përkasin specialistëve edhe në fushën e financës edhe në fushën e jurisprudencës.</p> <p><i>Pra nuk ekziston një studim i mirëfilltë tregu për këtë program studimi, që të bëjë një analizë mbi numrin e studentëve</i></p>

studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	potencialë që pritet të ndjekin studimet në financë, numrin e studentëve që ndjekin studimet në institucione private apo publike, të dhëna mbi mundësitë e punësimit të këtyre studentëve etj.			
Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Objektivat, struktura dhe syllabuset e moduleve të ofruara nga ky program studimi kanë për qëllim të garantojnë përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. <i>(Anex-III-1: Rregullorja e programit të studimit, neni 3 dhe 4).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	KU “Qiriazi” ka angazuar në veprimtarinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencorë pedagogë efektivë dhe me kontratë me përvojë në fushën e financës dhe kontabilitetit si dhe në disiplinat e tjera ndihmëse. Gjithashtu ai disponon edhe infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e programit të studimit të ciklit të parë të studimeve bachelor “Drejtues Finance”.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fakulteti i Ekonomisë i KU “Qiriazi” është njësia kryesore që ofron programin e studimit të ciklit të parë bachelor “Drejtues Finance”. Sipas nenit nr. 5 të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, FE është njësi akademike kryesore që mundëson formimin arsimor, profesional dhe shkencor në fushën e menaxhimit të biznesit dhe të financës, si dhe ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, në përfundim të të cilëve i pajis studentët me diplomë. Në këtë kuadër, fusha e studimit e programit të studimit të ciklit të parë “Drejtues finance” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e	Programi i studimit të ciklit të parë bachelor “Drejtues Finance” ofrohet nga Departamenti i Financës së FE të KU

<p>programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>“Qiriazi”. Neni 12 i rregullores së Departamentit të Financës së FE të KU “Qiriazi” përcakton si fushë të studimeve të Departamentit të Financës, financën në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, duke synuar arsimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në këtë fushë. Si rrjedhim edhe fusha e programit të studimit të ciklit të parë bachelor “Drejtues Finance” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Statuti i KU “Qiriazi”, si dhe Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë dhe Rregullorja e Departamentit të Financës përcaktojnë qartë detyrat e drejtuesve të njësisë kryesore dhe bazë si dhe të gjithë personelit akademik. Pavarësisht ndarjes së detyrave, për realizimin e tyre kërkohet edhe një bashkëpunim i ngushtë midis tyre në punë. Bashkëpunimi brenda institucionit vërehet në pjesëmarrjen edhe të pedagogëve të departamenteve të tjera në aktivitetin e mësimdhënies së programit të studimit të ciklit të parë bachelor “Drejtues finance”, meqënëse një pjesë e lëndëve janë të karakterit ndihmës dhe shpesh meqënëse numri i studentëve është i vogël, klasat bashkohen me ato të programeve të studimit që ofrohen nga njësi të tjera bazë. Nga takimi me pedagogë të programit të studimit, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi një klimë bashkëpunimi midis pedagogëve të cilët nëpërmjet mbledhjeve formale apo edhe takimeve informale bashkërendonin punën e tyre në institucion.</p>




<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësues dhe formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>KU "Qiriazi" ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda vendit (si Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Universiteti Politeknik i Tiranës, Albanian University, Universiteti European i Tiranës, Universiteti Mësdhetar i Shqipërisë, Shkolla e Mesme Teknikë në Tiranë, etj); jashtë vendit (si VH Burgenland University of Applied Science (Austri), Modul University Vienna), si dhe aktorë të biznesit brenda dhe të huaj (si Dhoma Idustrisë dhe Tregtisë Tiranë, Travelbest SRL, United Bank of Albania, Spitali Amerikan, Shoqeria Alb Juris, Alpha Eëb Business, Shoqeria"RAL VISIUALZ", etj.)</p>			
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu komunikua se rezultat i këtyre bashkëpunimeve ka qenë zhvillimi i dy konferencave ndërkobëtare, si edhe kurse të ndryshme kualifikimi të ofruara në KU "Qiriazi". <i>Gjithsesi GVJ nuk iu vu në dispozicion ndonjë raport analitik të përfitimeve konkrete nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimit, por u vu në dispozicion i njëjti dokument që ishte paraqitur në DVV (Lista e bashkëpunimeve).</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Nga komunikimi me përfaqësues të KU "Qiriazi", GVJ konstatoi se institucioni përpiqej që marrëveshjet zyrtare që kishte me institucione të tjera dhe aktorë të biznesit ti shfrytëzonte për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. Një raport i praktikës profesionale iu vu në dispozicion GVJ me kërkesën e tij gjatë vizitës në institucion. Gjithsesi në këtë program studimi, numri i vogël i studentëve në vitin e fundit të studimit (dy) krijonte mundësi të mira të institucionit në këtë drejtim.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>GVJ konstatoi se KU "Qiriazi" ofron trajnime profesionale si për studentët potencialë edhe për ata të diplomuar. Në këtë program studimi ende nuk ka student të diplomuar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ekspertët e vlerësimit të jashtëm, pas konsultimit me dokumentacionin përkatës të vënë në dispozicion (<i>Rregullore e programit të studimit "Financë", neni 3</i>), gjykojnë se KUQ është mbështetur në VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 për organizimin e lëndëve dhe shpërndarjen e tyre në grupet karakterizuese, të vlerësuara me kredite dhe orë brenda dhe jashtë auditorit/ kredit. Ky program studimi është i shtrirë në tri vite akademike, me gjashtë semestra. Çdo vit akademik ka një ngarkesë prej 1500 orësh në auditor dhe jashtë tij, që përkon me 60 kredite ECTS". (<i>Dosja e organizimit dhe drejtimit të programit të studimit Bachelor "Drejtues Finance"</i>).</p> <p>Gjithashtu institucioni përcakton: sipas formave të mësimdhënies të parashikuara në planin mësimor ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit për çdo kredit është 25 orë. Për lëndët, në auditor zhvillohen rreth 10-12 orë mësimore për kredit dhe pjesa tjetër realizohen si orë jashtë auditorit".</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit si edhe sillabuset e lëndëve, synojnë formimin e studentëve me njohuri të gjithanshme në fushën e kontabilitetit dhe menaxhimit financiar.</p> <p>GVJ konstatoi se kurrikula e programit përbëhet kryesisht nga lëndë të formimit karakterizues (53%), lëndë të karakterit integruar (14%), lëndë plotësuese (11%) si gjuhët e huaja, informatikë, praktika dhe lëndë bazë (18%), që u krijojnë mundësinë studentëve të orientohen drejt një kategorie më të gjerë profesioneve e specialitetesh brenda fushës së financës. Metodatat dhe format e mësimdhënies përfshijnë leksionet dhe mësimdhënien ndërvepruese ku synim kryesor është që studenti të përftojë aftësinë e aplikimit të njohurive të menaxhimit financiar, të parashikimit financiar dhe të bazave të kontabilitetit e të marrëdhënieve me klientët, si dhe të ketë aftësi gjyqësore dhe komunikuese. (<i>Dosja e organizimit dhe drejtimit të programit të studimit Bachelor "Drejtues Finance"</i>).</p>

	<p>Objektivat kryesore të programit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> T'i përgatisë studentët që të jenë të aftë të pozicionohen në karrierën profesionale në fushën e kontabilitetit dhe të menaxhimit financiar, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik; Të formojë specialistë të fushës së menaxhimit dhe analizës financiare dhe kontabël me nivel të lartë në aftësi profesionale dhe përgjegjësi sociale, të aftë t'u përgjigjen sfidave të zhvillimit të shoqërive tregtare në kushtet e konkurrencës rajonale dhe globale; <p><i>(cituar nga Rregullorja e programit bachelor "Drejtues Finance", neni 4 dhe nga Dosja e organizimit dhe drejtimit të programit të studimit Bachelor "Drejtues Finance", pika 4.3).</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Misioni i programit të studimit Bachelor në "Drejtues Finance" është të përgatisë specialist "Drejtues Finance" që në përfundim të programit të studimit, të zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme profesionale për të menaxhuar veprimtari ekonomike të vogla e të mesme publike e private. Ky program studimi ka si mision t'i pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e financës.</p> <p>GVJ konstatoi nga vizitat në institucion se drejtuesit e institucionit por edhe pedagogët e lëndëve angazhohen maksimalisht për të sjellë njohuri bashkëkohore pranë studentëve të programit. Kjo shprehet edhe në rinovimin e përvitshëm të syllabuseve dhe pasurimin e tyre me literaturë të përditësuar të viteve të fundit, e cila pasqyron njohuritë dhe risitë e kësaj fushe akademike dhe transmetimin e tyre tek studentët në auditor, me krijimin e nje laboratorit ku përdoren softëare të kontabilitetit dhe ku studentët praktikojnë raste kompanish reale dhe mbajtjen e librave të tyre.</p> <p>Gjithashtu rregullorja e programit dhe dokumentat e tjerë <i>(si syllabuset lëndore, literaturën e përdorur, etj)</i> shprehin mangësi në lidhje me nevojat e tregut të punës dhe njohurive apo kompetencave që kërkohen sot, për shkak të mangësisë të një studimi të mirëfilltë tregu. KUQ disponon një analizë tregu <i>(Aneksi I_12)</i> por në të pasqyrohen të dhëna të vitit 2014; gjithashtu nuk pasqyron metodologjinë statistikore të përpunimit të të dhënave.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose</p>	<p>Kurrikula e programit përbëhet nga lëndë dhe module të cilat synojnë t'i pajisin studentët me aftësi dhe kompetenca profesionale në fushën e studimit. Sillabuset e lëndëve që përbëjnë këtë program studimi, në ndërtimin e tyre, e cila</p>

profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	pasqyrohet tek temat e leksioneve që trajtohen gjatë zhvillimit të tij, transmetojnë një nivel të avancuar informacioni në këtë drejtim, i cili i aftëson studentët përzgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e menaxhimit financiar të biznesit.			
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Pas shqyrtimit të dokumentave bazë: kurrikulën e programit nën vlerësim, planin mësimor, programet mësimore, sillabuset të lëndëve/moduleve përbërëse, si edhe rregulloren e programit të studimit, GVJ gjykon që ky kriter përmbushet dhe programi pasqyron elementet e përcaktuara në VKM Nr.41 datë 24.01.2018. Kontrolli i dijeve kryhet me anë të detyrave/projekteve të kursit individual ose në grup dhe provimeve të ndërmjetme dhe forma të tjera të cilat janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në sillabuset e lëndëve/moduleve. Grupet e seminarit janë në përputhje me tabelën 2 të VKM 41, me më pak se 35 studentë/grupi.			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit është i ndarë në module dhe lënde me karakter formues dhe profesional, duke respektuar peshën e kategorive të lëndëve (A, B, C, D, dhe E), në mbështetje të VKM Nr.41 datë 24.01.2018. Gjithashtu kreditet (ECTS) specifikohen në përputhje me raportin e orëve teori/praktikë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Veprimtaria e KUQ u pezullua në vitet akademike 2014-2015, 2015-2016, dhe u ri-hap me urdhër të MASR Nr.397 dt. 22.07.2016. Në vitin 2018, KUQ përfundoi procesin e akreditimit institucional me ekspertët e huaj (<i>Anex I 19 Akte nënligjore KUQ</i>). GVJ shqyrtoi me kujdes dokumentacionin bazë dhe gjen përputhshmëri të rregulloreve të fakultetit dhe departamentit si njësi kryesore/bazë për ofrimin e programit të studimit bachelor në “Drejtues Finance”, me Ligjin 80/2015, Për

	<p>Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore që rrjedhin nga ai.</p> <p>(Anex_I_3_Rregullorja e KUQ, Kreu I-II); (Anex_I_5_Manuali i cilësisë; Anex_II_1_Rregullorja e FE, neni 1,5,6); (Anex_II_6_Rregullorja e Departamentit Financë, neni 1)</p>			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Në KUQ, Përgjegjësi i departamentit luan rolin e koordinatorit dhe zbatuesit të programit të studimit nën shqyrtim (Anex_II_6_Rregullorja e Departamentit të Financës, neni 6).</p> <p>Ai drejton të gjithë veprimtarinë mësimore dhe shkencore, kontrollin e tij si dhe kryerjen e praktikave profesionale në përputhje me objektivat e caktuara. Përgjegjësi i departamentit informon në vazhdimësi Dekanin e FE për ecurinë e zbatimit të programit.</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë në KUQ përbëhet nga 2 departamente dhe një njësi kërkimore-shkencore. Referuar dokumentit (Anex_II_7_Numri i stafit Akademik FE_2016-2018) Fakulteti Ekonomik dhe departamenti i Financës, si njësi kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, nuk i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti gjatë tre viteve akademike ka patur në përbërjen e tij 9 pedagogë në total, nga ku 5 pedagogë efektivë (PAE), nga ku 4 janë me gradë shkencore, dhe 4 pedagogë me kontratë (PAK), të 4 me grade. Drejtuesit e FE dhe Departamentit të Financës kanë tituj shkencorë, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015.</p> <p><i>Pas vizites në institucion, GVJ konstaton mosplotësimin e numrit të nevojshëm me staf akademik si dhe mangësi në firmosjen e dokumentacionit përkatës për stafin ekzistues në zyrën e Burimeve Njerëzore.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>				
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Financës është njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit Bsc në “Drejtues Finance”. Kjo njësi nëpërmjet stafit, procedurave dhe strukturave të saj mbledh, analizon, seleksionon dhe disponon informacionin e nevojshëm për programin e studimit. Organizimi i programit në module, struktura e tij e shpërndarë sipas viteve, dhe përmbajtja lëndore është kompetencë e plotë e Departamentit të Financës.</p> <p>Për mbarëvajtjen dhe funksionimin e programit të studimit institucioni ka hartuar Rregulloren e Brendshme të FE, Rregulloren e Departamentit të Financës si dhe Rregulloren e programit të studimit bachelor “Drejtues Finance”.</p> <p><i>(Referojuni dokumentacionit Anex III 2 1 Dosja e organizimit dhe drejtimit të programit të studimit Bachelor “Drejtues Finance”).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>KUQ duke u bazuar në VKM Nr.41, date 24.1.2018, “Për elementët e programeve të studimit” ka hartuar planin mësimor sipas Veprimtarive Formuese (A-E), kjo e pasqyruar në dokumentacionin bazë të programit dhe në RVB. <i>(Anex III 2 1 Dosja e organizimit dhe drejtimit të programit të studimit Bachelor “Drejtues Finance”).</i></p> <p>Plani mësimor i programit të studimit Bsc në “Drejtues Finance” shtrihet në 3 vite akademike; 6 semestra, secili prej të cileve përbëhet nga 15 javë, përvec semestrit të fundit i cili është 10 javë. Ky plan përcakton lëndët e programit të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese sic paraqitet në GVB dhe në dosjen e programit <i>(Anex III 2 1 Dosja e organizimit dhe drejtimit të programit të studimit Bachelor “Drejtues Finance”), konkretisht:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> A -Lëndë Bazë 18 % me 33 ECTS me 6 lëndë; B- Lëndë Karakterizuese 53 % me 96 ECTS me 17 lëndë; C-Lëndë Interdisiplinore / Integruese 14% me 26 ECTS me 5 lëndë; D- Lëndë Plotesuese 11% me 20 ECTS me 4 lëndë; E – Detyrime përmbyllse 3% me 5 ECTS me 1 lëndë;
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit bachelor “Drejtues Finance”, në KUQ është e organizuar në lëndë e module, të cilat janë të vlerësuara me kredite ECTS, ku 1 ECTS = 25 orë mësimore punë e studentit.</p> <p>1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor</p> <p>1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor</p>


	<p>1 ECTS ka 25 orë mësimore punë të studentit 1 orë mësimore 50 minuta.</p> <p>Këto informacione janë të detajuara në Rregulloren e programit, neni 9-10 dhe (<i>Aneksi III_2_1 "Dosja e programit të studimit"</i>)- "Për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve".</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentat baze dhe specifiku me planin e detajuar mësimor (<i>Anex III_2_1 Dosja e organizimit dhe drejtimit të programit të studimit Bachelor "Drejtues Finance"</i>), si edhe vizitat në institucion, programi i studimit bachelor në "Drejtues Finance" bazohet në Planin Mësimor, i cili përbën dokumentin kryesor për zbatimin e këtij programi dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Plani mësimor përfshin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor sipas kategorisë leksione, seminare, laboratore, praktike dhe orë jashtë auditorit si punë e pavarur, Në të njëjtin dokument, referuar metodës dhe formave të mësimdhënies përfshihen leksionet, mësimdhëna interaktive dhe frekuentimi i detyrueshëm.</p> <p>(<i>Anex III_2_1 Dosja e organizimit dhe drejtimit të programit të studimit Bachelor "Drejtues Finance"</i>),</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se KUQ është transparent përsa i përket procedurave dhe kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto informacione pasqyrohen në Rregulloren e programit të studimit në bachelor në "Drejtues Finance", e cila bazohet gjithashtu në Rregulloren e institucionit dhe Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe specifiku në (<i>Anex I_14 Kriteret e pranimit e transferimit të studentëve</i>).</p> <p>Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit bëhet publik në faqen e internetit të Kolegjit, rrjetet sociale, në broshurën informuese dhe gjatë fushatës mediatike.</p> <p>Gjate vizitave në sekretarinë mësimore të KUQ, GVJ konstatoi një procedurë normale transferimi, ku për pranimin e studentëve të transferuar institucioni ngre një komision ad hoc nga departamenti i cili bën dhe ekuivalentimin e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët</p>	<p>Syllabuset e lëndëve të programit nën shqyrtim përmbajnë informacion të detajuar për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, dhe janë hartuar në përputhje me formatet ligjore të përcaktuara. Procedura e hartimit të tyre kalon nga titullari i lëndës/modulit, shqyrtohet në departament dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe Dekani i fakultetit.</p>

<p>formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Sillabuset përmbajnë informacione të përgjithshme si titulli i lëndës/modulit, emrin e titullarit që e zhvillon, ngarkesën në orë dhe kredite, tipologjinë e lëndës (kategorinë), vitin dhe semestrin kur zhvillohet lënda, llojin e lëndës, programin mësimor të cilit i përket, kodin e lëndës/ modulit dhe adresën elektronike të titullarit të lëndës.</p> <p>Sipas RVB komponentët e vlerësimit të studentëve përcaktohen edhe në sillabet e cdo lënde. GVJ konstatoi se ndarja e notës sipas komponentëve në sillabe ndryshonte për provimin përfundimtar; në disa sillabe ai ishte 50%, në të tjera 60%, ndërkohë që sipas intervistave u referua se ishte një komponent që kishte gjithmonë 50%. Gjithashtu u vërejt se notat përfundimtare të dorëzuara nga pedagogët nuk ishin të ndarë në komponentë. GVJ-së nuk ju vu në dispozicion një dokument i tillë pas kërkesës së tij.</p>								
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi i studimit nën shqyrtim është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. KUQ ka komisionet lëndore të cilat së bashku me departamentin e Financës, në fillim të çdo viti akademik, diskutojnë përmbajtjen e programeve të studimit dhe problematikat e hasura.</p> <p><i>(Referoju Vendimit nr. 9 dt 09/10/2018 për shpërndarjen e lëndëve të studimit)</i></p> <p>Ndryshimet eventuale pasi miratohen në departament e fakultet arkivohen në sekretarinë mësimore. Ato pas miratimit janë reflektuar në të gjithë elementët e dosjes së programit të studimit.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="596 1323 775 1429">Nëse përmbushet</th> <th data-bbox="775 1323 978 1429">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="978 1323 1174 1429">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1174 1323 1396 1429">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="596 1429 775 1485"></td> <td data-bbox="775 1429 978 1485"></td> <td data-bbox="978 1429 1174 1485"></td> <td data-bbox="1174 1429 1396 1485" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nëse përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nëse përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi II.4</p>	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e</p>	<p>Ngarkesa e programit është përcaktuar në rregulloren e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe pasqyrohet edhe në planin mësimor. Sipas kësaj rregulloreje, studentët duhet të realizojnë një sasi mesatare prej 60 kreditesh të grumbulluara</p>

nënligjore në fuqi.	për cdo vit akademik. Në përfundim të programit të studimit studentët duhet të plotësojnë 180 kredite në mënyrë që të mund të diplomohen. Programi i studimit nën shqyrtim, shtrihet në tre vite akademike, i ndarë në 6 semestra, i organizuar mbi bazën e lëndëve ose moduleve dhe i vlerësuar me kredite (ECTS).
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Kurrikula e programit detajohet në planin mësimor dhe në sillabuset e lëndëve/moduleve. Programi i studimit Bsc në “Drejtues Finance” synon t’i ofrojë studentëve njohuritë e nevojshme për t’ju mundësuar punësim në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe në vecanti në financë dhe kontabilitet. Ndër objektivat kryesorë të programit është të përgatisë studentët në fushat e menaxhimit dhe analizës financiare si dhe të kontabilitetit për sektorin publik dhe provat. Lëndët e programit, të karakterit të përgjithshëm dhe profesional (sipas legjislacionit në fuqi) si dhe praktika dy javore e parashikuar gjatë semestrit të fundit të studimeve ndikon në arritjen e objektivave dhe të krijimit të profesionistëve në fushat e financës dhe kontabilitetit. Sipas analizave periodike, vjetore të punës mësimore të Senatit, Fakultetit dhe departamentit, rezultojnë se programi ka një ngarkesë të plotë mësimore dhe raport të ekuilibruar teori - praktikë.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Ngarkesa e programit, në orë mësimore (1500 orë) dhe kredite (180 ECTS), i përmbahet përcaktimeve ligjore për këtë cikël studimi dhe e përfaqëson atë me programe të tjera të ngjashme në fushën e financës. (<i>Anex III 2 1 Dosja e organizimit dhe drejtimit të programit të studimit Bachelor “Drejtues Finance”</i>), GJVJ pati informacion për sa i përket arritjes së objektivave të programit të studimit që përfshijnë të dhëna të sakta në lidhje me punësimin e të diplomuarve nga KUQ; por në numra këto të dhëna konsiderohen shumë pak për të rezultuar përmbushje të objektivave të programit. GJVJ vëren se emërtimi i programit Bsc në “Drejtues Finance” është më i specializuar krahasuar me objektivat e programit që përfshijnë edhe specialistë në kontabilitet.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<i>GJVJ vëren gjithashtu se në përputhje me programin “Drejtues Finance dhe për të pasur përfaqësim me programe të ngjashme ndërkombëtare nevojiten module më të specializuara si “Menaxhim Portofoli”, “Derivate Financiare”, “Modelim Financiar” apo “Teoria e Lojës”, “Analiza Big Data” etj.</i>

<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Drejtues Finance” pranë KUQ është i ndarë në lëndë dhe module formuese ku peshën më të madhe e zënë ato tipit karakterizues (53%), duke ruajtur raportet formimit teorik dhe praktik (sipas ligjit). Kjo gjë mundëson transferimin dhe mobilitetin e studentëve në institucion dhe jashtë tij. Këto informacione janë të detajuara në Rregulloren e programit, neni 9-10 dhe <i>(Aneksi III_2_1 “Dosja e programit të studimit)- “Për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve”.</i></p> <p>Për sa i përket punësimit rastet e paraqitura gjatë vizitës në instucion dhe nga dokumenti përkatës <i>(referoju “të dhëna për punësimin” tek dokumentacioni shitesë)</i> ishin të pakta në numër. Gjithsesi praktikat mësimore përfshinin dhe transferimin e studentëve në vënde fqinjë për punë sezonale <i>(referuar studentëve të ikur në Itali).</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter u vërejt se drejtuesit dhe stafi akademik i KUQ punon për përditësimin e vazhdueshëm të literaturës çdo fillim semestri, kjo e pasqyruar në sillabuset përkatëse të lëndëve si dhe në procesin e rishikimit dhe përditësimit të tyre. Disa prej anëtarëve të stafit akademik japin kontributin personal me publikime shkencore të cilat i vihen në dispozicion edhe studentëve. Sillabet po ashtu përfshijnë literaturë ndërkombëtare për studentët. Nga vizita në bibliotekën e institucionit, ajo ishte e përditësuar me burimet e literaturës të përdorura për programin e studimit. <i>Por kishte mangësi në përditësimin e saj me literature të huaj.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi i studimit synon ti ofrojë më së miri studentëve përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të nevojshme në përfundim të ciklit të parë të studimeve. Kjo e pasqyruar në rregulloren e programit të studimit (neni 4) dhe përmbledhjen dhe rezultatet e të nxëniet në sillabuset e lëndëve të ofruara.</p> <p>KUQ shprehet ne raportin e tij te vleresimit, se studentët pas përfudimit të programit te studimit kanë fituar aftësi të tilla si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të njohin dhe të kuptojnë saktë menaxhimin një biznesi; 2. Te realizojne analizë të mirëfilltë te marketingut dhe te biznesit; 3. Të mundin të auditojnë pasqyrat fiannciare dhe veprimtarinë e një biznesi;




	<p>4. Të kuptojnë funksionimin e nje biznesi dhe menaxhimin e tij;</p> <p><i>GVJ sugjeron të rishikohen aftesitë që studentët përfitojnë në përfundim të programit dhe ti përshatin me profilin financiar sic parashikohet në Rregulloren e Programit.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit integron lëndë nga fusha të ndryshme të ekonomisë, gjë e cila i hap dyert studentëve për të vijuar më tej karrierën e tyre akademike ose punësim pas mbarimit të programit. Fakulteti i Ekonomisë ofron programet e studimit në ciklin e dytë: Master Profesional në “Administrim Biznesi” dhe “Financë” si dhe Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” dhe “Financë”, të cilat studentët mund t’i ndjekin për te thelluar njohuritë e tyre.</p> <p>Për sa i përket punësimit GVJ është shprehur edhe më sipër se nuk mund të gjykojë pasi nuk ka rekorde të mjaftueshme në lidhje me të punësuarit të diplomuar nga programi i studimit.</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ vlerëson përpjekjet e instucionit për përshtatjen sa më shumë të programeve të ofruara me kërkesa të tregut të punës. KUQ bën analizat vjetore të punës mësimore të kryera në nivel Fakulteti dhe departamenti për programin e studimit, duke analizuar propozime të sjella në lidhje me ndryshimet e mundshme të tij.</p> <p><i>Për të realizuar sa më mirë këtë objektiv dhe përmbushur këtë kriter, GVJ sugjeron kryerjen e një studimi të mirëfilltë tregu, ku të analizohen nevojat e tregut të punës sot dhe identifikimin e atyre moduleve/lëndëve të reja që do të pasyronin kurrikulën e programit të studimit. Gërshetimi i këtyre nevojave me njohuritë profesionale do të mundësonin përgatitjen e specialistëve që i mungojnë tregut të punës sot. Kjo gjë do t’i jepje një avantazh konkurrues edhe vetë insitucionit në të ardhmen.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Drejtues Finance”, është në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Referuar dokumentit (<i>Anex III 5 Të dhënat e sta akad prog studi DF 2018-2019</i>) rezulton se në realizimin e programit të studimit janë angazhuar gjithsej 19 pedagogë, nga të cilët 13 janë pedagogë efektiv (PAE), 9 me tituj e grada shkencore, dhe 6 me pedagogë me kontratë (PAK), të gjithë me tituj e grada shkencore.</p> <p>Pas vizites në institucion, GVJ ka verejtur se dokumentacioni i dosjeve të stafit për programin e studimit ka pasur mangësi në firmosjen e kontratave.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i të dhënave (<i>Anex III 5 Të dhënat e sta akad prog studi DF 2018-2019</i>) si dhe nga analiza e CV të personelit (<i>Anex III 2 3 CV pedagog Bsc DF</i>), GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit është i larmishëm si në tituj e grada ashtu edhe në eksperiencën profesionale. Institucioni ka angazhuar pedagoge të kategorisë “Profesor” të cilët pëcjellin përvojën në fushat që mbulojnë dhe njekohesisht mbështesin kualifikimin e pedagogëve me të rinj, të atashuar pranë tyre. Disa prej tyre kanë kryer kualifikime e specializime jashtë vendit sipas fushave përkatëse dhe disiplinave që mbulojnë. Kështu nga 13 personel akademik efektiv, 1 ka titullin Prof. Dr., 2 Prof. Asoc. Dr., 6 Dr. dhe 4 Msc. Personeli me kohë të pjesshme përbëhet nga 2 Prof. Dr, 1 Prof. Asoc. Dr., dhe 3 Dr.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në program është me tituj dhe grada shkencore të cilat përgjithësisht përkojnë me natyrën specifike të moduleve që mbulojnë. GVJ duke parë dosjen e programit në lidhje me stafin e mësimdhënës (<i>paragrafi VI</i>) dhe duke parë ekspertizën e stafit akademik nëpërmjet CV-ve të tyre, konstatoi disa raste si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Lëndët “Shkrim Akademik” dhe “Sociologji” nuk përputhen me kualifikimin akademik të pedagoges që i ofron. 2.Lënda “Hyrje në Biznes” nuk përputhet me kualifikimin akademik të pedagogeve që e ofrojnë. 3.Lënda “Tregje dhe Institucione Financiare” nuk përputhet me kualifikimin akademik të pedagoges që e ofron si titullare. <p><i>Nevojitet që KUQ të rishikojë kualifikimin akademik dhe fushat kërkimore të stafit akademik që t’i përgjigjen natyrës</i></p>

	<i>dhe specifike të lëndëve e moduleve që ata zhvillojnë.</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Duke pasur parasysh numrin e vogël të studentëve në total por edhe të atyre që diplomohen dhe kryejnë praktikën profesionale, KUQ përmbush detyrimet ligjore duke respektuar edhe raportin pedagog/student për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. Përzgjedhja e institucionit/subjektit në të cilin do të zhvillohet praktika profesionale bëhet në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës.</p> <p>KUQ ka organizuar konferenca shkencore (<i>Anex I-17, I-17-1</i>) në bashkëpunim me institucione të tjera, ka marrë pjesë në panairë pune, etj. Këto dhe veprimtari të tjera specifike që janë kryer nga Fakulteti si psh. leksione të hapura, departamenti ka vënë në dispozicion dhe ka mbuluar me personel akademik duke bashkëpunuar ngushtësisht me studentët për të rritur nivelin e pjesëmarrjes së studentëve dhe përfshirjen e tyre në këto veprimtari.</p>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<p>Ky kriter garantohet nga numri i vogël i studentëve që ka ky institucion. Në lëndën e informatikës e cila ka orë laboratorike seminarët dhe puna në laborator realizohen nga pedagogu i lëndës së informatikës, i cili kujdeset për mirëmbajtjen e pajisjeve laboratorike e mjediseve të tjera mësimore si dhe të teknologjisë së informacionit që përdoret në procesin mësimor. Edhe në lëndën e kontabilitetit financiar përdoren laboratorët për të realizuar realizimin praktik të orës mësimore të lëndës.</p> <p>Shërbimet e internetit dhe riparimi i pasiveve elektronike janë mirëmbajtur nga firmat me të cilat KUQ ka kontrata shërbimi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Organizimi i studimeve rregullohet nëpërmjet nenit nr. 49 (Kreu III) të Statutit të KU “Qiriazi” ku jepen udhëzime mbi format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe kontrollit të dijes. Këto forma parashikohen në veçanti në planet mësimore, programet e moduleve dhe rregulloren mësimore të programit të studimit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Në vitin 2017 KU “Qiriazi” ka miratuar dokumentin “ <i>Politikat e vlerësimit të brendshëm</i> ” dhe në muajin tetor të 2018 KU “Qiriazi” ka miratuar dokumentin “ <i>Manual i Cilësisë</i> ”. Sipas këtyre dokumenteve, sigurimi i brendshëm i cilësisë është ndërtuar duke respektuar kërkesat ligjore dhe përmbushjen e misionit të KU “Qiriazi”. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë me vendim të Senatit Akademik është ngritur dhe funksionon në mënyrë permanente “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” e cila raporton direkt tek rektori dhe ka si objektiv kryesor cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kjo njësi ka si mission të ideojë, drejtojë, organizojë dhe publikojë veprimtarinë e vlerësimit të brendshëm në nivel institucioni dhe programesh studimi. NJBSC ka autonomi vepruese dhe akses për të gjitha të dhënat në KU “Qiriazi”. Roli i NJBSC është të krijojë një kulturë që synon të arrijë dhe të ruajë një cilësi të lartë të veprimtarisë akademike dhe kërkimore.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Një nga metodat e vlerësimit të mësimdhënies është edhe përfshirja e studentëve në vlerësim. Përveç komunikimit të vazhdueshëm që studentët kanë me pedagogët e tyre dhe përgjegjësin e departamentit, ku shprehin komentet apo ankesat që mund të kenë lidhur më një lëndë apo pedagog specifik, studentët plotësojnë edhe një formular anonim në fund të çdo semestri lidhur me lëndën që kanë ndjekur gjatë atij viti. Formulari plotësohet në formë të printuar, ndërkohë nga takimi me grupin e NJBSC u konfirmua se po punohet që ky formular në të ardhme të plotësohet on-line.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike	Një nga funksionet e NJBSC, sipas dokumentit “ <i>Politikat e Vlerësimit</i> ” është që të bëjë publike rezultatet e vlerësimit. Edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ-së iu konfirmua se publikimi i

rezultatet e vlerësimit.	<p>rezultateve të vlerësimit bëhet nëpërmjet takimeve, materialeve të shkruara si raporte, njoftime, buletine broshura apo edhe nëpërmjet faqes zyrtare të internetit.</p> <p><i>Gjithsesi GVJ u njoh vetëm me formularin qe duhet të plotësohet nga studentët, por nuk mori ndonjë informacion lidhur me përpunimin e rezultateve të pyetsorëve të mëparshëm.</i></p> <p>Raporti vjetor i 2016-2017 i vënë në dispozicion në DVV është një përmbledhje e Statutit të kolegjit dhe rregulloreve të tij, por nuk bën një analizë të vitit akademik. Po ashtu edhe dokumenti nr. 16 i vënë në dispozicion pas vizitës së GVJ në institucion, “Raporti i vlerësimit të brendshëm të NJBSC”, nuk bën një analizë të punës, por më shumë përqëndrohet në kërkesat, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen për realizimin e programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në tetor të vitit 2018, KU “Qiriazi” ka nxjerrë një udhëzues mbi kualifikimin e stafit akademik (<i>Aneksi I.7.1, që në fakt është pa firmë dhe i papërfunduar</i>) i cili ka për qëllim garantimin, promovimin zhvillimin e metodave cilësore dhe bashkëkohore të mësimdhënies. Ky udhëzues kërkon që të përgjithësohet përvoja më e mirë duke organizuar leksione të hapura me pedagogët më me përvojë, apo edhe diskutime, tryeza të rrumbullakta në rang grupe lëndësh departamenti deri fakulteti, për didaktikën në mësimdhënie dhe mësimnxënie, si dhe të bëhet vlerësim publik për pedagogun e ri më rezultativ. Ndër të tjera sikurse u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion, KU “Qiriazi” ka menduar që në të ardhmen të organizojë edhe një ceremoni mbi mësimdhënien më të mirë, duke akorduar cmimin “Qiriazi”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e</p>	<p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve janë përcaktuar në syllabuset e lëndëve, të hartuara në bazë të rregullores së programit të studimit</p> <p>Format e mësimin teorik e praktik janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, praktikat profesionale, detyrat e kursit etj. Ndërsa format e kontrollit të dijeve përfshijnë testimet</p>

<p>hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>ndërmjetëse, mbrojtje e punëve laboratorike dhe e detyrave të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provimet, mbrojtjet e temave të diplomave etj.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t' u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Pavarësisht rekomandimeve që jepen në rregulloret e Departamentit, të Financës, apo të programit përkatës të studimit, syllabuset e lëndëve janë pothuaj të unifikuar, por jo plotësisht.</p> <p>Kjo “liri akademike” është lejuar në mënyrë që stafi akademik tu përshtatet objektivave të secilës lëndë dhe të ofroj diversitet duke iu përgjigjur edhe nevojave të studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>KU “Qiriazi” i ofron personelit akademik të gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe e mbështet atë për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve që jep mësim. Për këtë arsye ka organizuar edhe leksione/seminare mbi metodat e reja të mësimdhënies në mënyrë që të rritë performancën e të gjithë personelit akademik, veçanërisht atë të ri.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit, pavarësisht se është i pamjaftueshëm në numër, përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve në mësimdhënie. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij të mësimdhënies. Për këtë qëllim, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sipas dokumentit “<i>Politikat e vlerësimit të brendshëm</i>” vlerësimi i mësimdhënies bëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgjegjësi i Departamentit, i cili bën vlerësimin e pedagogëve të rinj gjatë tre viteve të para të punës së tyre në institucion. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet vizitave në mësim (<i>një procesverbal i këtyre vizitave iu paraqit GVJ në takim</i>) dhe shqyrtimit të dokumentacionit të lëndës.

	2. Studentët të cilët plotësojnë një pyetësor javën e fundit të zhvillimit të lëndës. Formulari i vlerësimit të mësimdhënies përgatitet nga NJSBC. Informacioni I marrë nëpërmjet këtij formulari përdoret për vlerësim formues, diagnostikues dhe përmbledhës. Nëpërmjet përgjigjeve pedagogët marrin një informacion mbi mësimshënien që i ndihmon ata në përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	KU “Qiriazi inkurajon përdorimin e metodave interaktive të mësimdhënies, e cila u konfirmua edhe nga pedagogët e programit të studimit të ciklit të parë bachelor “Drejtues Finance”, të cilët përpiqen që të zhvillojnë diskutime brenda fushës së lëndës për ta bërë më tërheqëse orën e mësimit.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Inkurajimi i diskutimeve dhe debateve gjatë orës së mësimit, ndihmon studentët në shprehjen e mendimit të tyre dhe krijimit të një autonomie të menduari dhe të gjykuari. Numri i vogël i studentëve në këtë program studimi, u jep mundësi pedagogëve që ti lejojnë studentët të diskutojnë më shumë dhe të shprehin hapur opinionet e tyre, duke vendosur edhe një marrëdhënie të ndërsjellë të respektit midis tyre. Një marrëdhënie e tillë respekti u konfirmua edhe nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Aktiviteti mësimor në KU “Qiriazi” realizohet në një godinë, në pronësi të tij, e cila ka ambjente të mjaftueshme dhe cilësore për numrin aktual të studentëve. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se ambjentet janë komode, të ndriçuara mirë, të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me	Ambjentet e dedikuara procesit mësimor (<i>salat e mësimit dhe laboratorët</i>) janë të pajisura me logjistikën e nevojshme (tavolina, karrike, kompjuter, projektor, tabela etj.) dhe bëjnë të mundur

logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	realizimin e një procesi mësimor cilësor.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Meqënëse KU “Qiriazi” ka në strukturën e tij edhe Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, ka mundësi që tu ofrojë edhe programeve të tjera të studimit, si në rastin e programit të studimit të ciklit të parë “Drejtues Finance”, një infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor, si për sa i përket laboratorëve të informatikës, por edhe përdorimit të platformës on-line si nga studentët edhe nga personeli akademik i këtij programi studimi.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse e përcaktuar në syllabuset e lëndëve, është kryesisht në shqip, në përputhje me gjuhën e programit të studimit. Ajo është e përshtatshme dhe garanton marrjen e njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka e institucionit ofron hapësira të mjaftueshme për përdorim nga studentët në funksion të procesit mësimor. Për sa i përket literaturës në bibliotekë, ajo përbëhet kryesisht nga literatura bazë dhe ishte e kufizuar në numër (një për titull). Për shkak të këtij kufizimi në numër titujsh studentët nuk kanë mundësi që të tërheqin librat nga biblioteka për studim jashtë ambjenteve të kolegjit. <i>Sipas syllabuseve, pjesa më e madhe e lëndëve kanë literaturë që i përket dekadës së fundit.</i>
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Deri tani, institucioni nuk ofron library on-line, por në platformën on-line që përdoret nga studentët dhe personeli akademik kanë hedhur për përdorim titujt e literaturës bazë që përdoret nga studentët.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të	KU “Qiriazi” ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit të ciklit të parë bachelor “Drejtues finance” dy laboratorë informatike, që përdoren jo vetëm për orët laboratorike të procesit mësimor, por mund të përdoren nga studentët edhe për punën e pavarur të tyre në qëllim të procesit mësimor.

vazhdueshme nga studentët.									
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Personeli akademik përdor platformën on-line në të cilën vendos materialet mësimore dhe komunikon me studentët. Nëpërmjet kësaj platforme studentëve u komunikohet edhe vlerësimi nga pedagogu.								
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët kanë mundësi të përdorin platformën e tyre on-line si dhe sisteme të tjera të komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.								
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Fakulteti i Ekonomisë i KU "Qiriazi" ka hartuar edhe kërkesat që duhen patur parasysh gjatë hartimit të punimit të diplomës. Sipas këtij dokumenti studenti ka të drejtë që të zgjedh vetë temën e studimit, por mund të konsultohet edhe me pedagogun udhëheqës. Pas përcaktimit të fushës së studimit, studenti harton së bashku me udhëheqësin një skedë që përfshin të gjitha hapat, nga fillimi deri në përfundimin e punimit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së	Për sigurimin dhe promovimin e cilësisë, KU "Qiriazi" ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila funksionon në bazë të rregullores së saj të miratuar nga Kryetari i Senatit Akademik në mars të vitit 2017. Neni nr. 8 i rregullores përcakton edhe detyrat e NJBSC që nga monitorimi i procesit të mësimdhënies, koordinimi i aktiviteteve të kontrollit, vendosjes së objektivave në përputhje me vizionin e kolegjit, publikimit të raporteve të vlerësimit dhe deri tek propozimi i aktiviteteve për përmirësimin e monitorimit periodik si dhe dhënien e

mësimdhënies.	rekomandimeve për përmirësimin e cilësisë dhe planifikimin strategjik të njësive akademike dhe administrative.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Statuti i KU “Qiriazi”, Rregullorja e FE dhe Rregullorja e Departamentit të Financës, përcakton Dekanin në nivel të njësisë kryesore dhe Përgjegjës të Departamentit të Financës në nivelin e njësisë bazë, si përgjegjës për zhvillimin e procesit të mësimdhënies dhe për drejtimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Nëpërmjet leksioneve të hapura, diskutimeve dhe tryezave të rumbullakta, strukturat përgjegjëse promovojnë eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies. Infrastruktura e ofruar në ambjentet e mësimdhënies mundëson realizimin e metodave inovative të mësimdhënies.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	CV e pedagogëve të programit të studimit të ciklit të parë “Drejtues Finance” dëshmojnë për një pjesëmarrje aktive të personelit akademik në konferenca si brenda dhe jashtë vendit, si dhe botime të ndryshme në revista shkencore që rritin kuallifikimin shkencor të tyre.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Personeli akademik inkurajohet nga institucioni për të rritur kualifikimin e tij shkencor për të ndihmuar në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Në këtë drejtim KU “Qiriazi” ka zhvilluar leksione të hapura për përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe ka marrë pjesë edhe në dy konferenca ndërkombëtare, ku pedagogët e tij kanë marrë pjesë me punime shkencore, të financuar nga KU “Qiriazi”.
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Sipas statutit të KU “Qiriazi” personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të institucionit, këshillim për studentët etj. Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor shkencor. Si personeli akademik dhe personeli ndihmës/akademik mbështesin realizimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose kërkimit shkencor. Angazimi i personelit akademik dhe atij ndihmes, garantohet edhe nga neni nr. 3 i Kontratës së punës, i cili specifikon detyrat e punëmarrësit për realizimin sa më mirë të procesit mësimor. Detyrimet dhe të drejtat e personelit akademik dhe ndihmës/akademik përcaktohen në nenet 103 dhe 104 të Rregullores së Fakultetit Ekonomik.
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës	Gjatë vizitës në institucion, GVJ- së iu komunikua se personeli akademik dhe ndihmës/akademik testojnë vazhdimisht metoda të

akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	reja mësimdhënie, të cilat i diskutojnë në mbledhje departamenti apo edhe në takime informale midis kolegëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Rregullorja e Departamentit të Financës dhe Rregullorja programit të studimit të ciklit të parë bachelor “Drejtues Finance” përcakton se vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit për elementët e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit; - vlerësimi përfundimtar; <p>Si forma bazë të kontrollit të dijeve rregullorja parashikon provimin dhe kolekiumin. Gjithsesi sipas tyre mënyra specifike e kontrollit të dijeve përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit.</p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Sipas rregullores së programit të studimit mënyra e kontrollit të dijeve të studentëve u bëhet e ditur studentëve që në orën e parë të zhvillimit të mësimin nga pedagogu. Cdo syllabus lëndë/moduli përcakton vlerësimin me pikë për cdo komponent të vlerësimit të studentit: kolekiumi, angazhimi në mësim, detyra/projekte kursi, provimi përfundimtar etj.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e	Meqënëse testimi i njohurive bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit, ai përfshin forma të ndryshme të kontrollit të dijeve nga punët me shkrim dhe diskutimet/debatet me gojë gjatë procesit mësimor. Rregullorja e programit të studimit lejon që provimi të kryhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar sipas gjykimit të pedagogut dhe duke u dhënë mundësi studentëve të tregojnë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

fituara.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Sipas rregullores së Departamentit të Financës testimi dhe vlerësimi i njohurive realizohet në dy faza: <ol style="list-style-type: none"> 1. kontrolli i fazës së parë kontrollin e vazhdueshëm gjatë procesit mësimor përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentëve në leksione, seminare, ushtrime, punë laboratorike, provimet e ndërmjetme detyrat e kursit, praktikën mësimore; 2. kontrolli i fazës së dytë që përfshin provimin përfundimtar; Vlerësimi përfundimtar përfshin rezultatin e vlerësimit gjatë vitit dhe rezultatin provimit përfundimtar.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Sistemi elektronik përdoret nga institucioni për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve të testeve, por jo në testim apo vlerësimin e provimeve.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Rregullorja e programit të studimit (<i>neni nr. 16</i>) rregullon dhe mënyrën e orgazimit dhe kryerjes së provimit. Studentët merren në provim nga dy pedagog: pedagogu i lëndës dhe asistenti përkatës të cilët kanë zhvilluar lëndën. Nëse lënda nuk ka asistent apo pedagogët e lëndës nuk mund të marrin pjesë në provim, përgjegjësi i departamentit cakton me shkrim pedagogë të tjerë, duke garantuar marrjen në provim nga komision prej së paku dy pedagogësh.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe	Neni 15 i Rregullores së programit të studimit përcakton mënyrën si zhvillohet provimi. Plotësimi i fletës së provimit me emrat e studentëve bëhet nga sekretaria mësimore, e cila nënshkruhet edhe nga Dekani dhe mban vulën e fakultetit. Neni nr. 63 i Rregullores së Fakultetit Ekonomik kërkon që kur provimet janë me shkrim të bëhet sekretimi i tyre. Fleta e provimit i dorëzohet komisionit të provimit ditën e provimit.

mjete survejimi.	
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënir për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i vazhdueshëm i njohurive të studentit që parashikohet në cdo lëndë/modul të programit të studimit i jep mundësi personelit akademik që të japë feedback dhe këshilla të vazhdueshme mbi procesin e mësimnxënies në mënyrë që ai të përmirësohet në të ardhmen. Kjo mundësohet nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm që i bëhet njohurive të studentit, vecanërisht gjatë zhvillimit të lëndës. Nëpërmjet njohjes me rezultatet e provimeve të pjesëshme, prezantimit të detyrave të kursit apo detyrave të shtëpisë, pedagogët u komunikojnë studentëve jo vetëm pikët e marra por edhe vërejtjet apo komentet që ata kanë lishur me përgatitjen dhe njohuritë e studentit.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua gadishmëria e personelit akademik për të shangur plagjiaturën dhe kopjimet në detyra dhe provime, e cila mundësohet edhe nga numri i vogël i studentëve në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit vlerësimi i studentit nga pedagogët merr në konsideratë edhe vlerësimin me pikë të kontrollit të vazhdueshëm gjatë mësimin edhe rezultatit e provimit përfundimtar. Vlerësimi i studentëve prej pedagogut bëhet si rregull jo më vonë se një javë nga data e zhvillimit të provimit.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit, që u konfirmua edhe nga takimet me studentët dhe pedagogët gjatë vizitës në institucion, në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu pret studentët (ndërkohë studenti është vënë në dijeni për vlerësim në platformën e tij) për të sqaruar çdo ankesë apo pretendim të mundshëm që mund të kenë lidhur me vlerësimin e tyre në provim. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në sekretrainë mësimore.</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Neni nr. 18. i rregullores së programit të studimit rregullon procedurën e ankimit të studentëve për vlerësimin e bërë nga ana e pedagogut. Ankimimi bëhet me shkrim brenda tre ditëve nga data e dhënies së provimit. Ankimimi i studentit shqyrtohet nga një komision i kryesuar nga Përgjegjësi i departamentit brenda të njëjtit sezon provimesh. Komisioni shqyrton fletën e provimit të studentit dhe në rast kur e vlerëson të arsyeshme e rimerr ne provim sërish studentin. Nota e vendosur nga komisioni është përfundimtare.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përmbyljes	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Përmbytja e planit mësimor të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Drejtues Finance”, garanton dhënien e njohurive të thelluara në fushën e financës dhe kontabilitetit. Programi synon të zhvillojë aftësitë profesionale të studentëve nëpërmjet shumë lëndëve të specialitetit që zhvillohen kryesisht në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve, të tilla si: marketing, bazat e kontabilitetit, parimet e kontabilitetit, investime, paraja dhe banka, drejtim banker, auditim, analizë e pasqyrave financiare, kontabilitet kosto derjtimi, tregje financiare, financa publike, taksim etj.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Përveç aftësive profesionale, programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Drejtues Finance” synon të pajisë studentët edhe me njohuri nga disiplina të tjera të nevojshme në fushën e teknologjisë së informacionit, humane e sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Kjo realizohet nëpërmjet kurrikulave të lëndëve si: “shkrim akademik” dhe “raportim ligjor”, “parimet e të drejtës”, “hyrje në sociallogji”, “informatikë”, “anglisht” etj.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Syllabuset e lëndëve parashikojnë objektivat që synon të arrijë lënda, si dhe njohuritë dhe kompetencat që priten të fitohen nga studentët në përfundim të çdo lënde. Nga takimet e bëra me pedagogët gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në përfundim të zhvillimit të lëndës, ata analizojnë ecurinë dhe arrijten e objektivave të programit të lëndës, të cilën e reflektojnë me ndonjë ndryshim të vogël në program në vitet në vazhdim.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Gjatë takimit me grupin e studentëve dhe të pedagogëve, u konfirmua që pedagogët në përfundim të çdo lënde, i orientojnë studentët për çështjet më të rëndësishme dhe kryesore të lëndës, në mënyrë që ata ti përvetësojnë më mirë për në provim si edhe të kenë mundësi ti zbatojnë në praktikë në të ardhmen.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja	Personeli akademik është angazhuar që ti njohë studentët edhe më zhvillimet e fundit të teknologjisë dhe të shkencës, si brenda orarit mësimor edhe jashtë tij. Jashtë strukturës së programit të studimit,

të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	në bashkëpunim me drejtuesit e FE dhe KU “Qiriazhi” janë zhvilluar leksione të hapura si nga pedagogë të KU “Qiriazhi” si nga lektorë të ftuar mbi të rejat në fushën e zhvillimit të teknologjisë dhe informacionit.			
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Syllabuset e lëndëve të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Drejtues Finance”, janë hartuar mbi bazën e njohurime dhe kompetencave që duhet të fitojë student në përfundim të cdo lënde. Për lëndë të veçanta kjo mundësohet nëpërmjet orëve laboratorike, si dhe në tërësi mundësohet nga praktika tre javore profesionale që duhet të kryesjnë studentët në fund të vitti të tretë.			
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Sipas syllabuseve të lëndëve të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Drejtues Finance”, vlerësimi i njohurive që fitojnë studentët bëhet edhe nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre dhe aktivizimit në diskutime gjatë orëve të leksioneve dhe seminareve, si dhe nëpërmjet mbrojtjes së detyrave të kursit. Këto element nxitin diskutimet dhe punën në grup nga ana e studentëve, në mënyrë që të arrijnë edhe një vlerësim të kenaqshëm në përfundim të zhvillimit të lëndës.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Gjatë zhvillimit të programit mësimor, personeli akademik stimulon studentët në zhvillimin e ideve inovative dhe në studime të avancuara kërkomore-shkencore, kryesisht nëpërmjet hartimit të detyrave të kursit dhe në fund mbrojtjes së praktikës profesionale dhe temës së diplomës.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	KU “Qiriazhi” mbështet zhvillimin e ideve inovative, zhvillimet në fushat kërkimore dhe shkencore duke ftuar studentët të marrin pjesë në leksione të hapura që trajtojnë këto tema si edhe në konferencat e zhvilluara në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë. Pjesëmarrja e studentëve në këto aktivitete ka qenë financuar nga institucioni.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Personeli akademik dhe drejtuesit e institucionit, përpiqen që të shfrytëzojnë marrëveshjet e bashkëpunimit në mënyrë që tu mundësojnë studentëve zhvillimin e praktikave profesionale si dhe mundësinë e përfshirjes në tregun e punës. Sipas RVB institucioni po punon për të shfrytëzuar këto marrëveshje, veçanërisht ato me institucione të huaja, për mundësuar mobilitetin e studentëve në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Provimi përfundimtar ose mbrojtja e diplomës rregullohen nga rregulloret e KU “Qiriazi”, rregullorja e FE, rregullorja e Departamentit të Financës, dhe në mënyrë më të detajuar nëpërmjet një dokumenti mbi kërkesat që duhen mbajtur parasysh gjatë punimit të diplomës viti 2017-2018.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Në funksion të mbrojtjes së diplomës KU “Qiriazi” ka vënë në dispozicion një dokument mbi kërkesat që duhen mbajtur parasysh gjatë punimit të diplomës viti 2017-2018. Në të përmbledhen udhëzime se cilat janë objektivat dhe si duhet strukturuar dhe shkruar një punim diplome. Por nga dokumenti vërehet se kërkesat janë të njëjta si për ciklin e parë të studimeve edhe për ciklin e dytë.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Neni 31 i rregullores së KU “Qiriazi” rregullon mënyrën e administrimit dhe realizimit të provimit përfundimtar. Programi i provimit të formimit është gjithëpërfshirës me tematika nga fusha kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga Departamenti i Financës, dhe miratohet nga Përgjegjësis i Departamentit dhe Dekani i FE. Provimi realizohet para një komisioni të posaçëm, të përbërë nga pedagogë të departamentit të fushave që mbulon programi i studimit. Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat që përfshihen në programin e provimit. Tezat hartohen nga anëtarët e komisionit, të cilët i përzgjedhin pyetjet në bazë të rëndësisë specifike të cdo fushe studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit të Financës harton programin e provimit përfundimtar, nëpërmjet të cilit studentët mund të përqëndrohen në çështjet apo fusha kryesore të studimit. Sipas RVB gjatë periudhës së sezonit të provimit përfundimtar/temës së diplomës, personeli akademik i departamentit është në dispozicion të studentëve për pyetjet e ndryshme që ata mund të kenë në lidhje me programin e provimit përfundimtar. Personeli akademik i departamentit i orienton dhe ndihmon studentët me pyetjet që mund të kenë në disiplinat që ata mbulojnë. Për këtë qëllim në sekretarinë mësimore, personeli akademik depoziton edhe oraret e pritjes së studentëve në zyrë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në</p>	<p>KU “Qiriazi” vë në dispozicion të gjithë infrastrukturën dhe mjediset e tij për të ndihmuar studentët për realizimin e analizave dhe testeve për realizimin me sukses të punimit të diplomës. Për</p>

mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	këtë qëllim studentët lejohen të përdorin bibliotekën, laboratorët e kompjuterave dhe mjedise të tjera për të cilat kanë nevojë për realizimin e punimit të tyre.								
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Rregullorja e KU "Qiriazi" përcakton se udhëheqësi i diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur dhe afatet e përafërta të reallizimit të tij. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, gjatë të cilave konsultohet dhe kontrollon puna e bërë sipas programit të miratuar. Pas përfundimit nga ana e studentit të punimit, udhëheqësi e rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe jep lejen për mbrojtjen e punimit para komisionit.								
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas nenit 85 të rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës studenti vlerësohet me notë. Nota llogaritet si mesatare e thjeshtë e notave të secilit anëtar të komisionit dhe i bëhet e ditur studentit ditën e mbrojtjes së diplomës para komisionit apo ditën e dhënies së provimit.								
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Sipas nenit 86 të rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, studenti që kalon me sukses temën e diplomës/provimin e formimit pajiset me diplomën përkatëse, e cila i jepet së bashku me Suplementin e Diplomës. Në dokumentin e diplomës shënohet fusha e studimit të përfunduar dhe specialiteti përkatës.								
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Sipas RVB, kolegji u vë në dispozicion studentëve programin e studimit vetëm kundrejt kërkesës së tyre në institucion.								
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Neni 90 i Rregullores së FE përcakton se në rast humbje diplome, KU "Qiriazi" nuk lëshon certifikatë, por i jep të interesuarit listën e notave dhe vërtetimin me fortografi, që është ekuivalent me diplomën, me vulën e Institucionit dhe të nënshkruar nga Dekani i FE dhe nga rektori i Kolegjit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Në përmbushje</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Personeli akademik propozohet nga Departamenti i Financës dhe në bashkëpunim me departamentin e Menaxhim Biznesit dhe departamentet e Fakultetit të Drejtësisë për lëndë të natyrës së përbashkët. Miratimi bëhet nga dekani i Fakultetit Ekonomik dhe Rektori i Kolegjit. (<i>referoju vendimit për shpërndarjen e lëndëve</i>). Kjo demonstroi një proces të institucionalizuar në lidhje me burimet njerëzore.</p> <p>Së fundmi KUQ ka krijuar të vecantë Zyrën e Burimeve Njerëzore, pasi më parë ishte së bashku me Zyrën e Karrierës. Nga intervistimi i personelit të Zyrës së Burimeve Njerëzore, por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo zyrë është përgjegjëse për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në fakultet, ruajtjen dhe përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë. Kjo zyrë edhe pse e re ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit (kryesisht të ri) por u vërejt se nevojitet të forcohet edhe më tepër dhe të funksionojë e pavarur nga zyra të tjera të institucionit. Personi përgjegjës sapo i kishte marrë detyrat dhe nevojitet një kohë përshtatjeje që të menaxhojë këtë zyrë në mënyrë eficiente.</p> <p>Nga investigimi i dy dosjeve të rastësishme të një PAE dhe PAK u vërejtën mangësi në dokumentacion, gjë të cilën zyra mori përsipër ta plotësojë. Për arsye të numrit të vogël të studentëve nuk ka personel ndihmës mësimor dhe administrativ në bazë Fakulteti.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar procedura (<i>Anex I-7</i>) për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë të reflektuara në Rregulloren e programit dhe atë të Fakultetit.</p> <p>Departamenti bën planifikimin për staf akademik bazuar në numrin e studentëve të planifikuar, dhe pasi miratohen nga Fakulteti publikohen në faqen e internetit të Kolegjit dhe mediat audiovizive</p>

	<p>e të shkruara. Cdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një Komision, i cili përbëhet nga drejtues të Rektoratit, fakultetit, departamentit dhe titullarit të lëndës që do japë mësim.</p> <p>Procesi i mësipërm është vërtetuar edhe nga stafi akademik i programit i cili u intervistua gjatë vizitës.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Rregullorja e Zyrës së Burimeve Njerëzore përmban të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me procedurat e rekrutimit të personelit. Bashkë me këtë ka përpiluar edhe udhëzuesin për kualifikimin e stafit akademik. Në vijim KUQ ka përcaktuar kriteret e përgjithshme për vlerësimin e kandidatëve për personel akademik (<i>Anex I_7, I_7_1 dhe I_7_2</i>) duke përfshirë kriteret eliminuese, kriteret të preferuara dhe vlerësuara dhe kriteret plotësuese. Në këtë dokument përcaktohen edhe pikat kryesore të intervistës gojore. Për cdo pozicion që publikon KUQ përcakton edhe kriteret e posaçme të rekrutimit.</p> <p><i>Për arsye të numrit të vogël të studentëve nuk ka personel ndihmës mësimor dhe administrativ në bazë Fakulteti.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit të personelit akademik, kriteret e përgjithshme dhe specifike hartohen nga departamenti i Finances dhe bëhen publike. KUQ, për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, ndan kriteret për vlerësimet e kandidatëve për staf akademik në:</p> <p>A. Kriteret eliminuese,</p> <p>B. Kriteret preferuese dhe të vlerësuara (me pikë)</p> <p>C. Kriteret plotësuese (me pikë)</p> <p>D. Intervistë gojore (me pikë)</p> <p>Duke ju referuar aneksit I_7_2.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efektive dhe efektive

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni

Infrastruktura në KUQ krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme

<p>angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p> <p>Institucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare, të pajisura me infrastrukturen e nevojshme mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerezore, Financa, Biblioteka, etj janë të akomoduar në ambjentet e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre. Institucioni ofron gjithashtu ambiente shlodhëse si bar/restorant, të cilat janë në dispozicion të stafit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni bën përpjekje për kualifikimin dhe zhvillimin profesional të personelit të programit, nëpërmjet organizimit të leksioneve të hapura, konferencave shkencore dhe trajnimeve për përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies.</p> <p>Këto aktivitete pasqyrohen gjithashtu edhe në web-faqen e institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Kolegji ka organizuar në bashkëpunim me “Albanian University” dhe IAL të tjerë, brenda vendit si dhe “La Sapiencia Itali” dy Konferenca Shkencore dhe shpezimet si dhe botimet e artikujve të mbajtur nga stafi akademik janë sponsorizuar nga Bordi i Administrimit.</p> <p>Me Akademinë e Shkencave është zhvilluar aktivitet i përbashkët për problemet e Etikës ku u referua nga Prof.Dr. Agim Binaj dhe është planikuar një tjetër në Qershor të këtij viti për problemet fiskale. Janë mbajtur leksione të hapura nga pedagog të ardhur nga SHBA, Gazetare nga Anglia, Opus Deinga Italia etj.”</p> <p>Duke filluar nga ky vit akademik, KUQ ka bere aktive nje platforme online "E-learning", ku secili profesor ka faqen e tij të cilën e pasuron me leksione dhe materiale të tjera të nevojshme për modulet që ofron. Pedagogu i informatikës i cili është përgjegjës dhe për mirëmbajtjen e kësaj platforme komunikimi, trajnon dhe asiston personelin dhe studentët për një përdorim sa me eficient të saj. GVJ inkukrajon nismën e KUQ në krijimin e aktiviteteve edhe me gjithëpërfshirëse gjatë vitit të ri akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Detyrat e stafit akademik dhe ndihmës janë të përcaktuar në rregulloren e institucionit, Fakultetit Ekonomik dhe Departamentit të Financës, si njësi bazë që përgjigjet direkt për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve bachelor ne “Drejtues Finance”. Ngarkesa mësimore sipas dokumentit shtesë të dorëzuar nga institucioni dëshmon për disa pedagogë deri në 360 orë mësimore në vit akademik, gjë e cila mund të vejë në diskutim eficienten e tyre, duke marrë parasysh edhe detyrat</p>

	administrative për të përmbushur.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	KUQ, si një institucion me numër të vogël studentësh. 270 ne total dhe 37 studente ne programin Bsc ne “Drejtimes Finance”, e përmbush kete kriter nga pikepamja e siperfaqes dhe mjediseve te nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Të gjitha mjediset e godinave kanë sisteme portative të fikjes së zjarrit, paketen e ndihmes së shpejtë. Në godinë ka të instaluar dy motogjenerator me paketa automatike, për furnizimin me energji elektrike, në rast ndërprerjeje të furnizimit nga rrjeti qëndror.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mesimore ne KUQ jane te pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, te tilla si tabela whiteboard dhe smartboard, wireless, te cilat mundësojne zhvillimin e mësimimit në kushte bashkëkohore. Dy laboratorët të cilët janë në funksion të zbatimit të këtij programi studimi, janë të kompletuar jo vetem me programet standarte por edhe specifike si p.sh <i>matlab</i> , <i>financa 5</i> në funksione të lëndëve të veçanta si elektronika, kontabiliteti si edhe shumë orë seminaresh të matematikës dhe statistikës.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave	

formues të programit të studimit në tërësi.				
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.				
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Insitucioni disponon nje liste marreveshjesh me institucione dhe biznese per kryerjen e praktikave profesionale prane tyre. Rregullorja e praktikës profesionale percakton detyrat e departamentit, stafit akademik dhe studentëve (<i>Anex_III_4</i>). KUQ ka ambjente studimi ne Biblioteke dhe kancelariku studentet mund te studiojne dhe kryejne detyrat e kursit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka krijuar një ambjent biblioteke në ndertesën e vet, me hapësirë të mjaftueshme, por ajo ka mangësi në lidhje me kushtet klimaterike dhe plan vendosjen e tavolinave në mënyrë që të shfrytëzohet maksimalisht nga studentet.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme	KUQ disponon nje Biblioteke e cila ka një fond librash,në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, duke përfshirë edhe tituj të fushës së programit të studimit Bsc në “Drejtues Finance”. Krahas literaturës fizike, institucioni përdor material ndihmëse dhe informuese për studentët si edhe forma e leksioneve në ppt. të cilat i vihen ne dispozicion studentëve nëpërmjet faqes online të secilit prej pedagogëve të programit te studimit.

dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.									
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Momentalisht biblioteka on-line nuk aplikohet në KUQ. Por, institucioni po punon për të siguruar bibliotekën online që të sigurojë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e saj pa pagesë.								
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Aktualisht Biblioteka nuk ka programe kompjuterike, por studentët mund të gjejnë listën e vendndodhjes së librave të bibliotekës nëpërmjet faqes së internetit të kolegjit, duke përdorur laboratorët e informatikës.								
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	KUQ bën përpjekje për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit, duke përfituar edhe nga donacionet e pedagogëve me botimet e tyre. Këtë vit ju shtuan dhe 740 libra e shumë revista nga Akademia e Shkencave në bazë të një marrveshje bashkëpunimi dhe pritet të sigurohet nga ajo dhe biblioteka on-line.								
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Sipas RVB dhe konstatimit në institucion biblioteka i vihet në dispozicion studentëve gjatë orareve publike e Hënë–e Premte nga ora 8.00-16.00. Ky orar përkon me oraret e zhvillimit të procesit mesimor, por konsiderohet i pamjaftueshëm për studentët të cilët mund të studjojnë jashtë këtij orari.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>KUQ është i organizuar institucionalisht për të menaxhuar informacionin e studentëve në të gjitha hallkat që prej pranimit e deri në diplomim. Për këtë ka ngritur Zyrat mbështetëse si Sekretaria Mësimore, Zyra e Mardhënieve me Jashtë, Zyra e Pranimeve dhe e Këshillimit të Karrierës. Këto zyra janë hapur pas heqjes së pezullimit institucional, në vitin 2016, dhe ofrojnë informacion kryesisht për institucionin që nga viti 2016. Po ashtu faqja zyrtare e internetit www.qiriazi.edu.al ofron informacione që nga kjo periudhë për studentët dhe stafin akademik– administrativ. Për një periudhë kohe personeli i këtyre zyrave ka qenë i përbashkët duke ofruar më tepër se një funksione. Institucioni nevojitet të ndajë dhe të pavarësojë edhe më tepër punën e këtyre Zyrave nga njëra tjetra.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit menaxhohen nga Zyra e Burimeve Njerezor.</p> <p>Në ndihmë të mirëfunksionimit të administrimit të informacionit KUQ po zhvillon sistemin e brendshëm elektronik të përdorshëm nga të gjitha palët e institucionit.</p> <p><i>GVJ konstatoi mangesi në firmosjen e dokumentacionit për PAE dhe PAK të angazhuar në program.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>KUQ siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Sekretaria ofron informacion më të specifikuar mbi programin e studimit, datat e provimeve dhe notat të personalizuara për çdo student.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Platforma elektronike lehtëson komunikim interaktiv dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis pedagogëve dhe studentëve në kohë reale.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për</p>	<p>Platforma elektronike e përzgjedhur dhe e zhvilluar për menaxhimin e informacionit ofron komunikim efektiv dhe të shpejtë midis palëve. Po ashtu numri i vogël i personelit akademik dhe administrativ ka lënë hapësira për të krijuar marrëdhënie të drejtpërdrejta gjë që i minimizon problematikat e menaxhimit dhe përshpejton zgjidhjet e problemeve.</p>

organet drejtuese dhe titullarët.									
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Sipas GVB Të gjitha informacionet për programet e studimit gjenden në web faqen e institucionit. Faqja www.qiriazi.edu.al here pas here ka probleme në shkarkimin e saj duke mos i mundur akses të menjëhershëm GVJ dhe ndoshta edhe kandidatëve që vijnë të aplikojnë në këtë kolegji.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Rregullat për shpërndarjen e burimeve dhe të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij përcaktohen nga Bordi i Administrimit, i cili është organi që mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit. <i>Mungon hartimi i nje plan-buxheti te detajuar me kostot per student per cdo vit te programit te studimit.</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Burimet financiare të institucionit mbështeten në kapitalin vetjak dhe të ardhurat nga ushtrimi i veprimtarive të tij. KUQ nuk ka përfituar grande apo donacione të tjera nga të tretët. Në dorëzimin e dokumentacionit shtesë të kërkuar nga GVJ një pjesë e fondeve është transferuar nga administratori për të përmbushur nevojat financiare. <i>GVJ vërejti mangësi në hartimin e një plan-buxheti të detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe fond të vecantë për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës apo aksesin në bibliotekat on-line.</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas RVB “Institucioni kryen çdo vit auditim të brendshëm e të jashtëm. Rezultatet e auditimit i bëhen të ditura Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik për të përcaktuar masat e nevojshme në vitin akademik që duhen për çdo program studimi. Për këtë KUQ ka aktmarrveshje me një firmë auditimi.”</p> <p>GVJ-së nuk ju vu në dispozicion një raport i brendshëm apo i jashtëm auditimi.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Sipas RVB-së, ky është cikli i parë i studimeve Bsc në “Drejtues Finance”, i cili përfundon këtë vit akademik. Institucioni ka hartuar raporte financiare për vitet 2017 - 2018. <i>Mungon hartimi i një plani ndërhyrjeje në rast se kërkohet për ecurinë financiare të programit të studimit.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Sipas praktikave të brendshme të institucionit, rregjistrimet kontabël dhe pasqyrat financiare përgatiten me bazë legjislacionin në fuqi, diskutohen dhe së fundmi miratohen në strukturat e kolegjit (Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit). Institucioni ka vënë në dispozicion informacionin lidhur me planin financiar dhe pasqyrat financiare që i përkasin viteve 2017-2018. Mangësi vërehet në shtrirjen e planit financiar për vitet akademike në vijim sipas parashikimeve të institucionit si dhe përlllogaritja e kostos për student. Burimi kryesor i të ardhurave për institucionin ngelet kapitali vetjak dhe veprimtaria kryesore e mësimdhënies.</p> <p><i>GVJ vërejtë mangësinë e një plan-buxheti të detajuar me të ardhurat dhe kostot për student për çdo vit të programit të studimit. Gjithashtu nuk vërehen përpjekje të mjaftueshme për të përthithur fonde nga projekte dhe grante në mënyrë që të garantohet qëndrueshmëria financiare në të ardhmen.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, KU "Qiriazi" ka hartuar rregulloren e KU, rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, rregulloren e Departamentit të Financës dhe rregulloren e programit të studimit të cilat specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga program i studimit.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek KU "Qiriazi" nga hyrja në dalje e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e kolegjit, të FE, të Departamentit të Financës dhe të programit të studimit. Në këtë program studimi ka patur edhe largime edhe transferime studentësh. Nga takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me jashtë dhe Pranimit dhe këshillimit për karrierë u konfirmua që institucioni përdorte ditet e karrierës për të bërë publike procedurat dhe kriteret e pranimit. Sipas RVB, politikat dhe procedurat bëhen publike përmes faqes së internetit të KU "Qiriazi", por nga një verifikim, nuk kishte asnjë informacion në këtë faqe.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Nga vizita në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (<i>Aneksi - I-14</i>) u konfirmua që KU "Qiriazi" miraton në fillim të vitit akademik kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve Bachelor, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret përkatëse.

Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.

Kriteret e përgjithshme të pranimit të studentëve të përcaktuara në rregulloret përkatëse dhe ato specifike të miratuara në fillim të çdo viti, hartohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë së arsimit.

Sipas nenit 6 të Rregullores së programmit të studimit, për tu pranuar në programin e studimit të ciklit të parë bachelor “Drejtues Finance” kandidati duhet të ketë përfunduar ciklin e arsimit të mesëm dhe provimet e detyrueshme të Maturës Shtetërore, si dhe të plotësojë kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të KM. Në këtë program studimi lejohet të ndjekin studime edhe kandidatë që kanë një diplomë tjetër të marrë nga një institucion jashtë vendit, por të njohur nga MAS, si dhe kandidatë që kanë një diplomë universitare, brenda ose jashtë Shqipërisë, dhe që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi.

Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.

Përpara cdo fillimi viti akademik, sipas informacionit që GVJ morri gjatë vizitës në institucion, KU “Qiriazi” njihet e interesuara me programin e studimit që ofron dhe kërkesat e përgjithshme dhe të vecanta për cdo program. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet ditëve të karrierës, vizitave në gjimnaze apo vizitave që kanë bërë maturanët në ambjentët e kolegjit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e kolegjit, FE, Departamentit të Financës dhe rregulloren e programit të studimit. Nëpërmjet “Zyrës së Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me jashtë dhe Pranimit dhe këshillimit për karrierë” rregulloret u vihen në dispozicion studentëve dhe u bëhen të njohura edhe nga takimet që kanë studentët me përgjegjësën e departamentit.
	Neni 27 i rregullores së KU “Qiriazi” përcakton kriteret e kalimit të studentëve në vitin pasardhës. Që student i vitit të parë të kalojë në vitin e dytë duhet të ketë marrë të paktën 30 kredite, ndërsa për të kaluar në vitin e tretë duhet të ketë fituar të paktën 80 kredite.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje	Rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë “Drejtues

me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.	Finance”, neni 22, përcakton procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike, si dhe lejon transferimin e studentëve të kolegjit në shkolla të tjera. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit. Studentëve u vihet në dispozicion rregullorja, nëpërmjet të cilës ata njihen me kriteret e transferimeve.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në programet e cdo lënde. Meqënëse programi u bëhet i ditur studentëve që orën e parë të mësimit, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në cdo lëndë.			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e kolegjit, rregulloren e FE, rregulloren e Departamentit të Financës dhe të programit përkatës të studimit. Kolegji ka hartuar edhe një udhëzues mbi punimin e diplomës që u bëhet i njohur studentëve nga takimet me përgjegjësën e departamentit dhe pedagogët udhëheqës të tyre.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në fillim të cdo viti akademik kolegji organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky kolegji. Këto takime të hapura janë zhvilluar edhe në shkolla të mesme por edhe duke i ftuar maturantët në ambjentet e kolegjit. Gjithashtu kolegji përgatit udhëzime, fletëpalosje dhe postera për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plot	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë.

programit të studimeve.	Gjithashtu informacion mbi organigramën e Fakultetit, dhe strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e kolegjit si edhe një informacion më pak i detajuar shfaqen në faqen e internetit të KU "Qiriazi".			
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët që ditën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimit u bëhet i njohur programi i lëndës. Një pjesë e këtij informacioni afishohet edhe në ambientet e institucionit. Sipas RVB në faqen e internetit të KU "Qiriazi" publikohen planet mësimore, por nga verifikimi i kryer, informacioni që ofrohet në faqen e internetit është shumë i pakët.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që regjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet "Zyrës së Burimeve Njerëzore, Marrëdhënive me jashtë dhe Pranimit dhe këshillimit për karrierë". Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me organizata publike dhe të biznesit.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e kolegjit lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leskioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj.			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Cdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët e teknologjisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Për këtë program studimi nuk ka ende studentë të diplomuar. Por për programet e tjera të studimit sipas RVB (për vitin 2017-2018), sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore, nëpërmjet rregjistrave përkatës mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, të transferuar dhe të larguar nga program i studimit për cdo vit akademik. Një përmbledhse e numrit të studentëve është vënë në dispozicion nga kolegji nëpërmjet dokumentit në (Aneksin-II_1_14). Ka mospërputhje të informacionit të marrë gjatë vizitës në sekretarinë mësimore (dokumenti "shenime gjatë vizitës") dhe dokumentit të sipërpërmendur.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore regjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në diplomimin e tyre.</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregullore e sekretarisë mësimore.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në fund të cdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të studentëve. Sipas dokumentave të paraqitur në dosjen e RVB studentët kanë hyrë me një mesatare nga 6,93 në 7,93, ndërkohë që nuk është llogaritur ende mesatarja e notave në përfundim të studimeve (meqënëse nuk ka mbaruar ende viti akademik, dhe dy studentët që kanë përfunduar vitin e tretë të studimeve do diplomohen në sezonin e vjeshtës).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Nëpërmjet Statutit të KU “Qiriazit” (neni 39), rregullores së FE (neni 99) dhe rregullores së Departamentit të Financës (neni 65) institucioni parashikon angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimarrëse e këshilluese (si Senati i KU “Qiriazit” dhe NJSBC) sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentet e vëna në dispozicion nga kolegji, GVJ konfirmoi se studentët ishin realisht të përfshirë në këshillim dhe vendimarrje. Studentët kishin përfaqësuesin e tyre si në Senatin e kolegjit, në këshillin e etikës (neni nr. 4 i Rregullores së Këshillit të Etikës) edhe në zyrën e NJBSC. Sipas Statutit ata kanë formuar edhe Këshillin studentor. Në RVB shkruhet për krijimin e Forumit studentor, organ i cili nuk parashikohet në dokumentet e përmendur më sipër. Nga vizita në institucion, në takimet me grupin e punës dhe studentët, u nënkuptua se duhet të ishte një “lapsus” përdorimi i emërimit Forum në vend të “Këshill”.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se programet e studimi janë hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve. Statuti i KU “Qiriazit” dhe rregulloret përkatëse parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtëpërdrejtë në këtë drejtim shërben edhe pyetori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri. GVJ konstatoi se pyetjet në pyetor lidheshin më shumë me performancën e pedagogut se sa me programin e studimit dhe në fakt nuk përbën një burim informacioni në këtë drejtim.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim</p>	<p>Rregullorja e FE (neni 67), rregullorja e Departamentit të Financës (neni 35) dhe rregullorja e programit të studimit të nivelit të parë</p>

mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	bachelor “Drejtues Finance” (neni 18) mundësojnë barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit studentëve si dhe nëpërmjet përcaktimit të procedurës që ndiqen nga institucioni në këtë rast.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	KU “Qiriazi” ka ngritur “Zyrën e Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me jashtë dhe Pranimet dhe këshillimit për karrierë”, e cila kryen disa funksione, përfshirë edhe atë të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve. Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Nga vizita në institucion, GVJ iu konfirmua se është një zyrë që kryen funksionet e të tre zyrave, për shkak të numrit relativisht të ulët të studentëve që ka kolegji. Me pritshmëritë që KU “Qiriazi” ka për të ardhmen, këto funksione do të kryhen nga zyra të vecanta.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në organet vendimarrëse, këshilluese dhe të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies, studentët kanë mundësi që të asistojnë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Të drejtat e studentëve në këtë drejtim, përveç dokumenteve të sipërpërmendur, përcaktohen edhe në Rregulloren e Zyrës për Marrëdhëniet me Jashtë, e Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë. Kjo rregullore e vënë në dispozicion në DVV, nuk është e firmosur dhe pavarësisht nga emërtimit (për të cilën gjatë vizitës në institucion u komunikua që përfshinte edhe buriment njerëzore) bën fjale vetëm për funksionet e zyrës së këshillimit dhe karrierës.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës.	KU “Qiriazi” ka hartuar një rregullore për organizimin dhe funksionimin e Zyrës për Marrëdhëniet me Jashtë, e Pranimeve dhe

<p>Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Këshillimit për Karrierë dhe ka ngritur edhe zyrën e Këshillimit të Karrierës. Nëni 2 i kësaj rregullore përcakton misionin dhe qëllimet e Zyrës së këshillimit për karrierë për ti shërbeyer nevojave për zhvillim të karrierës së studentëve, duke siguruar cilësi të lartë dhe shërbime të ndryshme nëpërmjet këshillimit, konsultimeve dhe partneriteteve të qëndrueshme, që nga organizimi i i përvitshem i prezantimit të programeve të studimeve në ambjentet e Fakulteteve, informimin e studentëve, lidhur me mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore, dhe mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme.</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Sipas rregullores së Zyrës për Marrëdhëniet me Jashtë, e Pranimeve dhe Këshillimit për Karrierë, një nga detyrat e kësaj zyrë është edhe perpilimi, plotësimi dhe përditësimi i Skedës se Punësimit për Studentët e nivelit Bachelor, Master Profesional dhe Master Shkencore. Nga vizita në institucion, GVJ iu konfirmua se kolegji ende nuk ka një zyrë Alumni, për shkak të pezullimit të programeve të studimit dhe numrit të pakët të studentëve të diplomuar deri tani. Ky program studimi nuk ka ende të diplomuar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p>Standardi VI.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet</p>	<p>KUQ në përmbushje të kërkesave të ligjit dhe të misionit të vet strategjik ka krijuar struktura dhe ka hartuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie. Këtë e ka paraqitur në Statut, neni 43, në rregulloren e Departamentit të Financës nenet</p>

ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	21-24, si dhe në objektivat e programit Drejtues Finance, neni 4. Po ashtu KUQ ka krijuar edhe rregulloren e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë ku përcaktohen të gjitha mekanizmat e arritjes së nivelit të dëshiruar të cilësisë. Njësia përkatëse është në varësi të Senatit Akademik, cka i siguron pavarësinë në punën dhe kompetencat e saj.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sistemi operativ i sigurimit të cilësisë sic përshkruhet në rregulloren përkatëse përbëhet nga manuali i sigurimit të cilësisë, procedurat, udhëzimet dhe format e përdorimit dhe standartet (pika 1.4 e rregullores së cilësisë). Institucioni e ka të ngritur këtë sistem dhe e monitoron nëpërmjet Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Në këtë Njësi përfshihen personel i brendshëm i Kolegjit; nuk ka anëtarë të jashtëm të pavarur dhe as përfaqësues të studentëve. Po ashtu anëtarët e saj janë mbajtës të disa funksioneve të tjera pedagogjike apo administrative, cka e vë në diskutim funksionin e saj të pavarur, sic e pasqyron organograma.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet 53are53 proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Instrumentat që përdor institucioni për vlerësimin e brendshëm janë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Anketimi i studentëve me anë të një pyetësori; 2. Mbledhjet e hapura; 3. Vlerësimi i pedagogut në orën mësimore; <p>Institucioni ka përfshirë në raportin vjetor të cilësisë masat e ndërmara në lidhje me raportet e ekspertëve të jashtëm dhe rekomandimet e tyre si dhe ka hartuar një plan veprimi për detyrat që ASCAL ka lënë për përmbushje. Ajo që nevojitet të shënohet është fakti i angazhimit i po të njëjtit staf që vendos detyra, i plotëson dhe i monitoron, duke mos patur pavarësi nga njëra-tjetra.</p> <p>GVJ vë në diskutim nëse mbledhjet e hapura (nëse janë të karakterit të matjes së performancës) e respektojnë privatësinë e stafit akademik, integritetin dhe personalitetin e tyre si dhe konfidencialitetin e informacionit. Raporti i vlerësimit të pedagogut në orën mesimore duket më tepër si një formular vlerësimi i performancës kundrejt objektivave vjetore, sesa si performancë në orën e mësimin. <i>Gjithashtu nuk ka një hapësirë për komente nga ana e të vlerësuarit. Në raportin vjetor të NJSBC nuk ka një analizë në lidhje me këto instrumenta të përdorura gjatë vitit akademik, konkluzionet e nxjerra dhe plan aksioni për t'i vendosur në funksion.</i></p>
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e	Instrumentat e përmendur më sipër përdoren në mënyrë periodike nga institucioni për vlerësimin e brendshëm. Këto instrumenta relativisht të rinj në përdorim të institucionit përfshihen edhe në raportin dhe manualin vjetor të Njesisë së Sigurimit të Cilësisë.

<p>cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e 54are54res së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Nuk ka pasur ndonjë shembull që këto mekanizma të kenë shënuar për të vërtetuar funksionin e tyre, për shkak se janë relativisht të reja në praktikë (vlerësimet nga studentët janë bërë në pranverë 2019.)</p> <p>Përvec përdorimit të mekanizmave sigurimi i cilësisë shtrihet edhe në rekrutimin e stafit, organizimin e programit mësimor, zhvillimin e programit dhe kërkimin. NJSBC në çdo rast është prezent për të siguruar cilësinë dhe për të krijuar një kulturë në rang institucional.</p> <p><i>Ajo që nevojitet të shënohet është fakti në angazhimin e po të njëjtit staf që vendos detyra, i plotëson dhe i monitoron, duke mos patur pavarësi nga njëra-tjetra.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Njësia bazë për menaxhimin e programit të studimit është Departamenti (Rregullore e Departamentit të Financës, neni 5 dhe 8). Kjo njësi bazë së bashku me NJSBC kryen mbikëqyrjen, rishikimin dhe monitorimin e programeve. Sic përmendet edhe tek Raporti vjetor NJSBC pika II, kjo Njësi ka si qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes ushtrimit të funksioneve të saj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Fakulteti Ekonomik me Departamentet përbërëse si dhe në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë krijojnë komisione ad hoc për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. Për shkak të numrit të vogël të studentëve dhe të praktikave të njëjta të ndjekura Departamentet kryejnë mbledhje të përbashkëta në funksion të proceseve të sipërpërmendura (<i>Shih proces-verbal i mbledhjes dt. 30/09/2018, se Departamenteve te Fakultetit Ekonomik per planin mesimor dhe shperndarjen e lendeve</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve institucioni monitoron periodikisht nepermjet instrumenteve të mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Anketimi i studentëve me anë të një pyetësoi; 2. Mbledhjet e hapura;

	<p>3. Vlerësimi i pedagogut në orën mësimore; Përdorimi i mekanizmave është relativisht i ri, kështu ngelet për t'u vlerësuar efikasiteti i mirëfeksionimit të tyre.</p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Per sa i perket rezultateve të instrumentave vlerësues e monitories, edhe pse janë përmendur në Raportin vjetor të NJSBC, nuk ka një analizë të mirëfillte të tyre për të kuptuar çfarë është vlerësuar dhe si ka qenë ecuria e vlerësimit, nëse janë marrë masa apo ka ndonjë plan aksioni për to.</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfaqësojnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Në raportet vjetore të Departamentit dhe në raportin e NJSBC duhet të përfaqësohet një analizë e detajuar e matësve kuantitativ dhe të adresohen mangësitë e ndryshme për përmbushje.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedurë e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfaqëson këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Departamenti i Financës i cili është përgjegjës për programin e studimit nën shqyrtim, bën vlerësime periodike të brendshme për programin e studimit dhe i pasqyron në raportin vjetor të analizës mësimore në nivel departamenti.</p> <p>Gjithashtu, departamenti realizon në mënyrë periodike analizë të punës mësimore, ecurinë e programit të studimit duke evidentuar problematikat dhe masat për zgjidhjen e tyre nëpërmjet angazhimit të stafit akademik dhe personelit ndihmës në departament, por edhe në nivele të tjera më të larta në qoftë se është e nevojshme. Ky vit është viti i parë i akreditimit të programit të studimit dhe KUQ i ka përfaqësojë këtë analizë për vetëvlerësim të brendshëm dhe vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit. NJSBC po ashtu në raportet e vjetore siguron vlerësimin e programit dhe garanton cilësinë në të gjitha hallkat e procesit.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e</p>	<p>KUQ perpiqet të menaxhojë dhe garantojë cilësinë e programit të</p>

<p>vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>studimit duke përdorur metoda e instrumente te ndryshme per kryerjen e vleresimit dhe matjen e performances se programit, sic paraqiten në regulloren e NJSBC.</p> <p>Senati Akademik dhe Fakulteti Ekonomik diskutojnë e miratojnë standartet në përputhje me Kodin e Cilësisë të ASCAL bazuar në Vendimin e KM Nr.531 datë 11.09.2018, të cilat përdoren për hartimin raportit vjetor si dhe ato të akreditimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>NJSBC pervec bashkepunimit me departamentin, angazhon edhe zyrat e tjera te institucionit, si ajo e Marredhenieve me Jashte dhe Keshillimit te Karieres, per te kontrolluar procesin mesimor dhe përputhshmërinë e tij me planet mësimore, duke përdorur metoda të drejtpërdrejta monitorimi si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së praktikave dhe ushtrimeve, testime të standardizuara, leksioneve të hapura etj, për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Fakulteti Ekonomik me departamentet për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metoda të tërthorta si sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; intervista të drejtpërdrejta; dëgjime në auditor; testime paraprake dhe përfundimtare; provime për modulet, praktikë; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>KUQ, diplomon brezin e pare te studenteve ne mbarim te ketij viti akademik.</p> <p>Por në Manualin e Cilësisë të KUQ, shprehet qartë që studentët inkurajohen të jenë pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor, nëpërmjet vlerësimit dhe ofrimit të mendimit të tyre pasi ata nëpërmjet përfaqësuesve janë pjesë e Senatit, Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të KUQ këshillave studentore, Komisionit të Etikes, etj.</p> <p>Gjithashtu, anketimi i studentëve është një instrument i rëndësishëm që përdoret për vlerësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit, rezultatete të cilit bëhen të njohura dhe shërbejnë si një bazë orientuese për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përfshirje	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>KUQ harton standardet për sigurimin e cilësisë të institucionit në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Institucioni ka shpërndarë përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet, rektorat) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të saj.</p> <p>Veprimtaria e NJSBC është e rregulluar sipas rregullores së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila është bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Statutin e Kolegjit Universitar „Qiriazi”.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregullorja e NJSBC-se përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe pale të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Sipas rregullores së Kolegjit, Zyra NJSBC përbëhet nga drejtuesit e zyrës, tre anëtarë të personelit akademik dhe një përfaqësuesi studentëve, por në takimin që GVJ pati, nuk kishte student të pranishëm. PO ashtu në raportet e Njesise nuk vërehet pjesëmarrja e studentit si pjesë e Njesise.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Finances është njësia baze përgjegjëse për cilësinë e programit. Disa nga anëtarët e departamentit janë pjesë e komisioneve të tilla si Komisionet për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Rregullorja e institucionit, Rregullorja e FE dhe Rregullorja e NJSBC, parashikon angazhimin e anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë</p>	

integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.									
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Sipas RVB-se, KUQ ka angazhuar edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. GVJ gjate vizites se tij nuk eshte njohur me ekspert te jashtem pjese te NJSBC.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijim in e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	KUQ ka nje procedure per vleresimin e mbarevajtjes mesimore. Insitucioni zhvillon nje pyetesor me studentet per vleresimin e moduleve dhe profesoreve ne fund te cdo semestri. Rezultatet e pyetesoreve i vihen ne dispozicion drejtuesve te insitucionit si edhe vete profesorit. Ato diskutohen ne mbledhjet departamentale dhe merren masat e nevojshme ne rast problematikash.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBC harton një plan vjetor të përvitshëm, ku parashikon te gjitha proceset e kontrollit dhe vlerësimit. Me pas harton raportet me gjetjet përkatëse. Raporti shpallet publikisht. Gjithashtu NJSBC informon në mënyrë periodike rektoratin, drejtuesit e fakulteteve, përmes tyre në mënyrë konfidenciale të gjithë stafin e KUQ rreth rezultateve të kontroleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësite të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan	Pas rezultateve te vleresimit, NJSBC-ja udhëzon njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre, duke dhene

masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	sugjerime për përmirësimin e veprimtarisë. Propozime të NJSBC shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit dhe reflektohen në vendimmarrje konkrete. Vitin e kaluar për RVJ institucional nga ASCAL pasi u diskutua në të gjitha nivelet e organeve drejtuese si dhe NJSBC e KUQ u hartua një plan masash për zbatimin e detyrave që dolën prej tij.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	NJSBC në KUQ harton raporte vjetore të vlerësimit të Brendshëm ku pasqyrojnë rezultatet e vazhdueshme të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të institucionit. Këto raporte dergohen në MASR. Gjithashtu diskutohen në Rektorat dhe Bordin e Administrimit, u bëhen të njohura strukturave përgjegjëse të Institucionit me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	KUQ i kushton rëndësi trajnimit të stafit përpërmirësimin njohurive të tyre mbi metodikën e mësidhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të institucionit. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të rinj, në drejtim të përgatitjes pedagogjike e psikologjike të tyre. KUQ organizon leksione të hapura dhe takime të drejtuesve të institucionit me studentët, merr mendimin e studentëve, nepermjet këshillit studentor, mbi çdo program studimor në tërësi, apo për çdo lëndë e pedagog të veçantë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Drejtues Finance”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Staf i akademik i kualifikuar që mbulon lëndët e programit është një komponent kyç për sigurimin e cilësisë së programit studimor;
2. Infrastruktura e universitetit ndihmon në përmbushjen e objektivave të programit;
3. Numri i vogël i studentëve krijon mundësi për një proces mësimor interaktiv dhe marrëdhënie të drejtpërdrejta pedagog-student;

4. Sistemi online për komunikimin e studentëve, pedagogëve dhe administratës siguron transparencën në monitorimin e të gjitha proceseve administrative dhe atyre të mësimdhënies;
5. Vullneti dhe dëshira e stafit akademik dhe administrativ për të punuar dhe ofruar programe cilësore duke rritur nivelin e mësimdhënies dhe të kërkimit;
6. Mbështetja e administratorit jo vetëm me inkurajimin për krijimin e infrasktrukturave organizative por edhe nga pikëpamja financiare tregon vullnetin për ta ngritur nivelin e kolegjit dhe të programeve që ofron;

b. Pika të dobta:

1. RVB edhe dokumente të tjera nuk janë shkruar posaçërisht për programin e ciklit të parë “Drejtues Finance”, por për programin “Manaxhim biznesi”, sepse ky emërtim shfaqet në një pjesë të madhe të tyre;
2. Ka mospërputhje midis emërimit të programit “Drejtues Finance” dhe rregulloreve që e rregullojnë këtë program që i referohen me emërtim “Financë”. Po ashtu Neni 11 i Rregullores së Departamentit të Financës përmban objektiva lidhur me të drejtën publike dhe administrative, që i referohen Fakultetit të Drejtësisë;
3. Komponentët e sillabuseve nuk janë në përputhje me rregulloren për sa i përket përcaktimit të përqindjeve të notës së studentëve, si dhe dorëzimi i notave nga pedagogët kryhet vetëm për notën përfundimtare, jo sipas komponentëve;
4. Faqja e internetit nuk jep informacion të plotë; në disa raste informacioni mungon (p.sh kriteret e pranimit të studentëve nuk shfaqen, apo planet mesimore që sipas RVB duhet të jenë të afishuara) dhe po ashtu në disa raste ka probleme me hapjen dhe ngarkimin e saj;
5. Nuk është bërë një studim i mirëfilltë tregu për këtë program studimi;
6. Numri i pedagogëve të Departamentit është nën kriterin minimal të kërkuar nga ligji dhe aktet nënligjore të tij. Në disa raste ekziston një mospërputhje midis kualifikimeve të stafit dhe lëndëve që ata japin në programin “Drejtues Finance”;
7. Bibloteka disponon vetëm një kopje të literaturës mësimore. Për këtë arsye studentët nuk mund të marrin libra nga bibloteka; gjithashtu mungon bibloteka on-line dhe mungojnë tituj të huaj në bibliotekë;
8. Ekziston një mangësi në pavarësinë e hallkave të procesit të sigurimit të cilësisë së mësimdhënies;

Rekomandime:

1. Të forcohet Programi i studimit për të reflektuar profilin e financës sipas emërimit që ka. Për këtë duhet të rishikohen dhe riorganizohen:
 - objektivat e programit të studimit
 - aftësitë e studentëve që përfitohen në përfundim të programit të studimit dhe
 - modulet e ofruara në program për të qenë më bashkëkohore.

2. Të rishikohen dokumentet dhe rregulloret që i përkasin programit mësimor të ciklit të parë "Drejtues Finance", që të mos përmbajnë elementë të programeve të tjera të studimit;
3. Të bëhet dallim midis kërkesave që studentët e ciklit të parë dhe ciklit të dytë duhet të plotësojnë për punimin e diplomës dhe punimin e mikrotezës;
4. Faqja e internetit të japë informacion më të plotë mbi programin e studimit dhe të zgjidhen problemet teknike me ngarkimin e saj;
5. Të kryhet një studim i mirëfilltë tregu ku të analizohen nevojat e tregut të punës sot dhe identifikimin e atyre moduleve/lëndëve të reja që do të pasuronin kurrikulën e programit të studimit. Gërshetimi i këtyre nevojave me njohuritë profesionale do të mundësonin përgatitjen e specialistëve që i mungojnë tregut të punës sot. Kjo do t'i jepje një avantazh konkurrues edhe vetë insitucionit në të ardhmen;
6. Të hartojë një Plan Strategjik të detajuar ku të përfshijë edhe planin e implementimit të gjetjeve nga Studimi i ri i tregut;
7. Të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues si edhe të bëjë përpjekje për t'u përditësuar në burime online të cilat do të nxisnin dhe pasuronin punën studimore-kërkimore të studentëve dhe stafit akademik, në mbështetje të programit;
8. Të plotësohet dhe firmoset dokumentacioni i PAE dhe PAK në zyrën e Burimeve Njerëzore;
9. Të rritet numri i pedagogëve efektiv sipas kërkesave ligjore dhe të përshtatet moduli i programit studimor me ekspertizën e pedagogut. Të rishikohet ngarkesa e stafit akademik me mësimdhënie dhe punë administrative, pasi konsiderohet e lartë në disa raste;
10. Të hartohet një plan-buxhet i detajuar me zërat përkatës për mbështetjen e trajnimeve dhe fond i vecantë për aktivitete kërkimore/shkencore për zhvillimin profesional të stafit akademik, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës/aksesin në bibliotekat on-line;
11. Institucioni dhe NJSBC veçanërisht, të shtojnë përpjekjet që stafi akademik të informohet dhe përfshihet në implementimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë;
12. Institucioni dhe NJSBC veçanërisht të përfshijë anëtarë të jashtëm të pavarur dhe përfaqësues të studentëve;
13. Të bëhet analiza vjetore cilësore dhe sasiore si e procesit të mësimdhënies edhe e kualifikimit shkencor të personelit akademik;

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first Bachelor cycle "Manager in Finance"

a. Strengths and affirmations:

1. The qualified academic staff that serves the modules ensures the quality of the study program;

2. The infrastructure of the university supports the accomplishment of the program's objectives.
3. The low number of students creates the opportunity for an interactive learning process and direct communication between instructors and students;
4. The online internal communication system used from the academic and administrative staff and the students guarantees transparency in monitoring the learning and administrative process;
5. The will and dedication of the academic and administrative staff to work and offer qualitative programs and increase the quality of teaching and research;
6. The support of the administrator to create the proper organizational infrastructure as well as to finance the activity shows dedication to increase the quality of this college and of the offered programs;

b. Weaknesses:

1. The internal self evaluation report as well as other documentation is not created for the study program "Manager in Finance", but for the program "Business Administrator", as it shows in several parts of this documents;
2. There is an inconsistency between the name of the program "Manager in Finance" and some of the internal regulations for this program, where it is referred as "Finance". Article 11 of the Regulation of the Department in Finance also includes objectives linked with public law and administration, which refer to the Law Faculty;
3. The syllabi components are not in accordance with the internal regulation considering the grading components and the delivery of grades from the instructors does not reflect the analytical components;
4. The web page of the college does not have full information ; missing information in some cases (ex. Admission criteria for freshman, or the schedule as it is referred to the SER). There are also problems with opening and uploading the page some times;
5. It does not exist a market research for this study program;
6. The number of full time academic staff for the Department does not comply with the law requirements. In some cases there is an inconsistency of the academics qualification and experience with the subject they teach;
7. The library has only one copy of the books, so students can't borrow; there is no online library and no t much foreign texts in;
8. There exists a lack of independence in the quality assurance system;

Recommendations:

1. To update the study program and make a proper reflection of its profile according to its name. In order to accomplish this, it has to be reviewed:
 - a. The program's objectives
 - b. The students' abilities gained by the end of the study program
 - c. The modules offered in this program to be more contemporary and in accordance to the actual programs in finance.
2. To review and reproduce all the documentation and regulations of the study program and to exclude elements of other study programs;
3. To distinguish the requirements for student being in the first and second cycle of their studies regarding their thesis;
4. The web page to be updated and filled with all the necessary information for the interested parties;
5. To pursue a market research, where the market need are detected and according to them new modules of the program to be updated and proposed in order to enrich the study program. These needs combined with the professional knowledge would create specialists that miss in today's market and would give a competitive advantage to the college;
6. To compose a detailed strategic plan that would include also the implementation plan of the market search findings;
7. To compose and implement a detailed plan for the library, adding books, funding with proper funds and creating the online library. This would encourage the academic and research work for the students and academic staff;
8. To complete and sign all documentation in HR office from part time and full time staff;
9. To increase the number of full time professors according to the legal requirements and to comply the subject with the professor's expertise. To review the workload of academic staff that performs both academic and administrative duties, as it is considered high in some cases;
10. To compile a detailed budget with special expenses for trainings, research activities for the development of academic staff and for the library to enrich the titles and access;
11. The institution and the Quality Assurance Office need to include and inform all academic staff in the implementation of the proper mechanisms of quality assurance;
12. The institution and the Quality Assurance Office have to include an independent member and a student representative in the Committee;
13. To pursue an annual report of the qualitative and quantitative measures for the learning process and the scientific qualifications of the academic staff;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Asnjë përmbushje	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc. Gentiana SHARKU


Dr. Andromahi KUFO